



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA			
Pravet - Prindëro Kërkim 24-01-2022 vit god			
Nr. Organi Kuvendi	Nr. Organi Kuvendi	Shtetë Prilog	Vlera Vendos
02-060/01-82			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008) dhe të nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, në nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e I të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **31.01.2022 (e Hënë)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit të Shtëpisë së Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

R e n d d i t e

1. a) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e datës 06.12.2021;
- b) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal e datës 28.12.2021.
2. Dhënia e betimit të anëtares të Kuvendit Komunal, znj. Taibe Ibahimi.
3. Informatë(raport) për punën e kryetarit të komunës për periudhën Janar-Dhjetor 2021
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2022.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB).
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacioni për ndertimin e objektit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për ndertimin e çerdhës së fëmijve në Viti.
8. a) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin e vendimit 01-110/05-976, të datës 28.12.2021, për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
- b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin e vendimit 01-110/05-974, të datës 28.12.2021, për formimin e Komitetit për Komunitete.

Viti, më 24.01.2022

Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosova



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Vitina

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prillogëna Mirëdora 20-01-2022 vit.gov.

Nr. i Organi Org. broj	Nr. i Broj	Shtetë Prilog	Vlera Vrednosë
02-052/01-47			

**INFORMATË (RAPORT) E PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS
PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2021**

Viti, Janar 2022

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I

Përmbledhje ekzekutive

- Hyrje	3
---------------	---

KAPITULLI II

Raportet e Zyrave të Kryetarit

- Njësia për Burime Njerëzore	4
- Zyra për Prokurim	4
- Zyra për Barazi Gjinore	5
- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun	6
- Zyra Ligjore	7
- Zyra Avokatit Publik të Komunës	8
- Zyra për Integritet Evropian	8
- Zyra për Projekte	9

KAPITULLI III

Raportet e Drejtorive

- Drejtoria për Administratë	10
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	13
- Drejtoria për Inspeksion	16
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë	20
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	25
- Drejtoria për Arsim	35
- Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit	47
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	49
- Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi	54
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	56

KAPITULLI I

HYRJE

Komuna si njësi themelore e pushtetit lokal, funksionon në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/08), Statutit të Komunës si akti më i lartë i Komunës si dhe ligjeve tjera me të cilat janë përcaktuar kompetencat dhe fushëveprimi i saj.

Qeverisja e mirë në komunën tonë ka qenë dhe do të jetë ndër objektivat tona kryesore dhe në përputhje me planin tonë strategjik, me të cilin plan synojmë të kontribuojmë në përmirësimin e shërbimeve komunale. Modalitetet e qeverisjes sonë gjatë kësaj kohe për të cilën raportojmë janë karakterizuar me ngritjen e performances në të gjithë sektorët, cilësinë e shërbimeve, si dhe transparencën komunale.

Politikat publike të komunës dhe harta e investimeve komunale janë treguesit më të mirë se Komuna e Vitisë ka shënuar rritje të besimit politik te qytetarët, te grupet e organizuara me interes, siç janë: bizneset, OJQ-të dhe shoqëria civile në përgjithësi. Janë rritur parametrat e vlerësimit të punës, është rritur cilësia e punimeve në infrastrukturë, si: rrugë, kanalizim, ujësjellës, mbrojtje të mjedisit, e të tjera.

Sa i përket funksionimit të shërbimit civil të Administratës Komunale të Vitisë, shërbimi civil është i paanshëm dhe i përgjegjshëm, ku këtë e dëshmon më së miri klima antidiskriminuese që është krijuar në Administratë, në të cilën çdo shërbyesi civil i është krijuar hapësirë e nevojshme veprimi për t'i shprehur mendimet e veta profesionale, gjë që ka rezultuar edhe me ngritjen e efikasitetit të punës në administratën komunale.

Raporti prezent, pasqyron përmbledhjen e punës për periudhën janar – dhjetor 2021 të të gjitha organeve komunale, duke përfshirë zyrat e kryetarit si dhe drejtoritë komunale me sektorët e tyre, me prioritetet si në vijim:

- Rritja e efikasitetit në Administratë
- Zhvillimi i bujqësisë
- Shëndetësia, arsimi, kultura dhe sporti
- Infrastruktura lokale
- Shërbimet publike
- Zhvillimi ekonomik
- Përkujdesja për shtresat e varfëra dhe grupet e marginalizuara
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile, donatorët dhe investitorët
- Mbrojtja e ambientit dhe kualiteti i jetës

KAPITULLI II

Raportet e Zyrave të Kryetarit

Njësia për Burime Njerëzore

Gjatë periudhës kohore janar – Dhjetor 2021, Njësia e Burimeve Njerëzore ka kryer punët në bazë të kompetencave dhe autorizimeve të cilat dalin nga Ligji për Zyrtares Publik, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin e Punës, Ligjin mbi Pagat, Ligjin mbi Administratën Shtetërore, Ligjin e Punës, si dhe aktet tjera nën ligjore: Statuti i Komunës dhe Vendimi mbi organizimin e organeve komunale dhe aktet tjera nënligjore të cilat rregullojnë fushën e marrëdhënies së punës.

Njësia e Burimeve Njerëzore për vitin 2021 në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës ka hartuar planin e Personelit në bazë të udhëzimeve të cilat janë dhënë nga Ministria e Administratës Publike, Departamenti i Shërbimit Civil si dhe Drejtorit përkatëse në veçanti me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Njësia e Burimeve Njerëzore ka zhvilluar të gjitha procedurat për pozitat, lëvizje paralele dhe për zyrtarët publik, të cilat i ka pasur në plan të personelit për pjesën e parë të vitit 2021.

Pozitat të cilat i kemi rekrutuar vitit 2021 sipas kërkesave të drejtorive dhe planit të Personelit janë 16, në drejtoritë e administratës komunale si dhe në sektorin e Arsimit, kurse ne konkurset me lëvizje paralele kemi rekrutuar këto pozita:

1. Pozita Udhëheqës i Inspektionit.
2. Udhëheqës i Tatimit në pronë.
3. Zyrtar ligjor në Drejtorinë e Financave, dhe
4. Udhëheqës i Auditimit në procedure të përfundimit.

Drejtoria e Arsimit për periudhën e shtatorit kemi rekrutuar me kërkesat e drejtorive të shkollave për secilën pozitë të kërkuar. Pozita gjithsej të pranuar janë: 13 profile profesionale në shkolla të mesme, kurse në shkollat fillore 17 pozicione nëpër fusha të ndryshme dhe 4 punëtorë teknik nëpër shkolla fillore.

Drejtoria e Shëndetësisë ka rekrutuar në muajin shtator 4 pozita për Doktor të Mjekësisë, kurse në muajin nëntor edhe tre doktor të mjekësisë familjare.

Ankesa ndaj konkursit publik të Drejtorisë së Arsimit kemi pasur 20, ankesa të cilat i ka shqyrtuar komisioni dhe ju ka dhënë përgjigje.

Vendime të shkuarjes në pension të rregullt të tre zyrtarëve të shërbimit civil. Vendimet për një pagë përcjellëse për tre zyrtarët e shërbimit civil. Vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës për zyrtarin të cilit kanë ndërruar jetë në shërbimin civil. Vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me vetëdëshirë të zyrtarit në Drejtorinë e Gjeodezisë. Vendime për një pagë për humbjen e anëtarëve të ngushtë.

Zyra për Prokurim

Me këtë raport njëvjeçar do të paraqesim të përmbledhur aktivitetet e prokurimit të zhvilluara për ofrimin e shërbimeve, zhvillimin e punëve gjegjësisht investimeve kapitale dhe furnizimeve me gjëra të ndryshme bazuar në kërkesat dhe nevojat e AK-së, që janë domosdoshmëri për plotësimin e aktiviteteve të komunës, bazuar në kërkesën e njësive shpenzuese dhe për realizimin e shpenzimeve buxhetore, si dhe për plotësimin e kërkesave të njësive buxhetore dhe mbarëvajtje pa pengesa të aktiviteteve të komunës, si dhe për realizimin e investimeve kapitale të planifikuara sipas buxhetit të këtij viti, e që është në interes të komunitetit dhe rritjen mirëqenies qytetare në përgjithësi. Punët dhe aktivitetet Zyra e Prokurimit i zhvillon, bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik. Bazuar në këtë, Zyra e prokurimit ka përgatitur këtë raport për kryetarin e komunës, duke përmbledh të gjitha aktivitetet e prokurimit për vitin 2021, në të cilin janë të përfshirë aktivitetet e realizuara të prokurimit dhe aktivitetet tjera të cilat janë në procedurë e sipër.

Në periudhën e vitit 2021, duke u bazuar në kërkesat e njësive shpenzuese, Zyra ka inicuar 67 aktivitete të prokurimit. Duke i ndarë ato sipas kategorive ose llojit të ndara në punë, shërbime dhe furnizime, kemi këto të dhëna; 18 aktivitete me lëndë prokurimi Shërbime, 16 aktivitete me lëndë prokurimi Punë dhe 22 me lëndë prokurimi Furnizime. Nga këto aktivitete, 56 janë përmbyll si aktivitete, tjerat janë në procedurë. Ndërsa lloji i procedurave e udhëhequra janë si vijon: 34 raste është përdorë procedura e hapur, 17 raste procedura e kuotimi i çmimit dhe 1 aktivitete procedurë me Vlera minimale, dhe 4 aktivitete procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.

Prej këtyre aktiviteteve të zhvilluara: 56 aktivitete të prokurimit janë përmbyll 45 dhe janë finalizuar me nënshkrimin e kontratave. Ndërsa 7 aktivitete të prokurimit janë anuluar, dy aktivitete janë në procedure të ankimit, ndërsa dy projekte nuk janë nënshkruar kantatat për mungesë të zotimeve nga Ministria e Infrastrukturës.

Zyra e prokurimit përveç këtyre aktiviteteve ka realizuar edhe pagesa për Operatoret Ekonomik që kanë kryera punë, furnizime apo shërbime sipas kontratave që kanë me komunën tonë.

Shuma e përgjithshme e shprehur në vlerën e kontratave të lidhura është **4,165.927.51 €**.

Ndër aktivitetet që zhvillon Zyra e Prokurimit është edhe nxjerrja e Urdhërblereve dhe procedimi i pagesave, gjatë kësaj periudhe kohore janë lëshuar **1143 Urdhërblere** për pagesën e OE të kontraktuar, duke udhëhequr lëndët për kompletim dhe janë dërguar në Thesar për pagesë gjegjësisht ekzekutim. Zyra e prokurimit ka kryer edhe **128 rekomandime** për vendimet e ndryshme të komisioneve për hapje dhe vlerësim dhe komisioneve tjera.

Në fund duhet potencuar se Zyra e prokurimit gjatë viti fiskal 2021, ka kryer punë dhe shërbime të ndryshme sipas kërkesave dhe nevojave të të gjithë njësive shpenzuese, duke ofruar këshillime dhe shërbime profesionale, me qëllimin e mbarëvajtjes së punëve në komunë dhe respektimin dispozitave ligjore në fuqi por edhe ka pranuar dhe proceduar të gjitha kërkesat që kanë ardhur nga këto njësi.

Zyra për Barazi Gjinore

Në raport janë prezantuar aktivitetet të cilat pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara përgjatë vitit 2021, ku prej tyre veçojmë:

- Takime dhe tryeza me shoqërinë civile, OJQ-të, komunitetin e të rinjve për implementimin e ligjeve të aplikueshme në funksion të të barazisë gjinore (2 takime);
- Përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjes “Njih të Drejtat” – prezantimi i të drejtave për trashëgiminë dhe pronën, konform ligjeve në fuqi, gjegjësisht LTK-së;
- Analiza gjinore dhe përgatitja e buxhetimit gjinor në kategoritë ekonomike: paga mëditje, subvencione dhe investime kapitale;
- Sigurimi i të dhënave statistikore nga këto sfera: zhvillim ekonomik; punësim / mirëqenie sociale; shëndetësi; procesin e vendimmarrjes;
- Organizimi i trajnimit për buxhetim gjinor;
- Dhënia e rekomandimeve në fushën e barazisë gjinore në përgjithësi për aktet normative komunale të aprovuara në KK përgjatë vitit 2021 (harmonizimi i tyre me ligjet që janë në funksion të barazisë gjinore);
- Organizimi dhe mbajtja e ligjëratave për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore, kundër dhunës në familje dhe keqpërdorimi i rrjeteve sociale;
- Trajnim për riintegrimin e viktimave të dhunës në familje me Mekanizmin Koordinues kundër Dhunës në Familje;

- Fuqizimi ekonomik i grave (bizneseve për vetëpunësim) përmes ndarjes së garantëve për zhvillimin e bizneseve (biznese për përpunimin e ushqimit), në partneritet me IADK, IKC, Caritas Zvicerran;
- Bashkëpunimi me Avokatin e Popullit për të pranuar ankesat e qytetarëve të Komunës së Vitisë për shkelje të të drejtave të njeriut nga institucionet;

Si dhe aktivitete tjera kontinuele.

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, gjatë kësaj periudhe ka publikuar dokumente mbi procedurat e konkurrimit dhe pranimin në punë. Nga procedura e prokurimit janë publikuar 55 kontrata të nënshkruara, 43 Njoftime për Kontratë, 40 Njoftime për dhënie të Kontratës, dhe 2 Planet dhe Raportet e Prokurimit Publik.
 - Janë publikuar gjithashtu edhe 89 Njoftime publike, 34 Vendime të Kuvendit Komunal, 54 Vendime të Kryetarit të Komunës, të gjitha draft dokumentet të cilat janë paraparë të shqyrtohen në Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin Komunal.
 - Kemi harmonizuar dhe funksionalizuar web faqen në gjuhën serbe.
 - Po ashtu janë publikuar edhe disa Plane e Raporte si dhe Dokumentet të cilët ndërlidhën me shpenzimin e parasë publike.
 - ☐ Një bashkëpunim të ndërsjellët dhe shumë të mirë, kemi pasur me mediat lokale dhe ato qendrore. Përmes adresave elektronike, gjitha mediave të shkruara, elektronike dhe agjencive të lajmeve u janë dërguar lajmet për ngjarjet nga komuna e Vitisë edhe përmes fotografive.
 - ☐ Zyra për Informim publik ka përcjell gjitha aktivitetet e kryetarit të komunës, apo edhe zyrtarëve të tjerë komunal në terren.
 - ☐ Pritjen e delegacioneve vendore dhe të huaj në komunën tonë.
 - ☐ Në kuadër të zyrës janë bërë specifikimet e shpenzimeve për publikime: Shpallje, Konkurse, tenderë, Njoftime etj.
 - ☐ Ndërkaq në kuadër të punës së Zyrës për Informim Publik, janë pranuar dhe shqyrtuar 17 kërkesat për Qasje në Dokumentet Publike.
 - ☐ Zyra për Informim ka marrë pjesë pothuajse në të gjitha trajnimet, punëtorit dhe mbledhjet e ndryshme për ndryshimin e pakos ligjore për Transparencë dhe finalizuar ndryshimin e Rregullores për Transparencë. Kurse gjatë vitit 2022 pritet të bëhet edhe hartimi i Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 4 vjeçare.
- Janë mbajtur edhe dy debatet e rregullta të kryetarit të komunës në formë elektronike. Debat i parë është mbajtur me datën: 28.06.2021, kurse pyetjet janë pranuar përmes platformës Google Forms. Në debatin e parë janë pranuar gjithsej 36 pyetje dhe komente nga ta 30 meshkuj dhe 6 femra.
- Debat i dytë i rregullt që është mbajtur në të njëjtën formë me datën: 28.12.2021. Janë pranuar gjithsej 10 pyetje dhe komente, nga ta 9 meshkuj dhe 1 femër. Këto debate janë transmetuar drejtpërdrejtë në rrjetin social facebook në llogarinë "Komuna e Vitisë" dhe nëpërmjet transmetimit të drejtpërdrejtë televiziv në Plus TV.
- Gjithashtu me qëllim të planifikimit të buxhetit komunal për vitin 2022-2024 në organizimin e Kuvendit Komunal dhe në bashkëpunim me DEFZH janë mbajtur 10 diskutime publike. Më poshtë keni një tabelë të takimeve publike të mbajtur me qytetarë gjatë vitit 2021 ku gjithsej janë

mbajtur 18 takime. Në këto takime kanë marrë pjesë 463 qytetarë prej tyre 417 meshkuj dhe 46 femra.

- Gjithashtu Zyra për Informim konkretisht Koordinatori Komunal për përfomancë, ka ndjekur të gjitha trajnimet lidhur me SMPK si dhe në bashkëpunim me zyrtarët raportues. Gjatë periudhës kohore Janar - Dhjetor 2021, si lektor Administratës së Komunës dhe i Kuvendit të Komunës së Vitisë, kam kryer punë dhe detyra të punës sipas përgjegjësisë zyrtare dhe përshkrimit të detyrave të vendit të punës. Kam lekturuar dokumente zyrtare për Zyrën e Kryetarit, për Kuvendin e Komunës, për drejtoritë, për njësitë dhe zyrat komunale etj.

Lektori

Gjatë periudhës kohore Janar – Dhjetor 2021 kam lekturuar këto dokumente:

1. Informata vjetore e Kryetarit të Komunës me drejtorit komunale 2020. Informata gjashtëmujore (janar-qershor) e kryetarit të komunës 2021; Prezantim i debatit me qytetar korrik-dhjetor 2021; Raporti i prezantimit të kryetarit; Rregullore për mbrojtjen e fëmijëve; Rregullore për ndryshimin/plotësimin e rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Vitisë, me nr. 01-110/05-183, të datës: 31.03.2021; Rregullore për këshillat e fshatrave 2021; Vendim 26.04.2021 (1); Konkurs publik për drejtor 07.06.2021; propozim vendim për miratimin e statutit të qendrës kryesore të mjekësisë familjare në viti 09.02.2021; Vendim për ankesë IPKO 2021; Vendimet 25.01.2021 (6); Vendimet, shkurt 2021(4); Vendimet 22.03.2021(6); Vendimet 22.04.2021(5); Vendimet 22.06.2021(4); Vendim për auditim të brendshëm 20.01.2021; Vendimet 27.07.2021(4); Vendimet 26.09.2021(3); Vendimet 21.12.2021(3); Kërkesë Agjensisë së Pyjeve; Kontrata për “Arena Sport”; Marrëveshje e mirëkuptimit dhe e bashkëfinancimit ndërmjet Komunës së Vitisë dhe ambulancave veterinarë “A.V” dhe “FARMAVET-M”; Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba 24.09.2021
2. Procesverbalet e Kuvendit Komunal, procesverbali XI (2020); I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, Mbledhja inauguruese e Kuvendit Komunal, Mbledhja e zgjedhjes së kryesuesit të Kuvendit Komunal (2021).
3. Procesverbalet e KPF-së XI (2020), I, II, III, IV, V, VI, VII (2021).

Gjithashtu kam ndihmuar edhe gojarisht zyrtarët sipas ndonjë kërkesë me gojë që më është shtruar dhe kam kryer punë shtesë.

Zyra Ligjore

Bazuar në dispozitat ligjore neni 74, pika d të statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, lidhur me dispozitat ligjore neni 46 të vendimit të Kryetarit të Komunës për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës Komunale, Zyra Ligjore në kuadër të ushtrimit dhe përgjegjësisë, autorizimeve si dhe në funksion të zbatimit të ligjeve dhe akteve me fuqi nën-ligjore, gjatë vitit 2020/21 ka bërë një punë cilësore duke kryer harmonizimin dhe korrigjimin e akteve nënligjore të propozuara nga Kryetari i Komunës dhe nga drejtorët e drejtorive si dhe hartimin e rregulloreve që janë në kompetencë të Komunës sipas Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040.

Zyra Ligjore për vitin 2021 ka harmonizuar bazën ligjore të:

400 vendime

280 propozim vendime

900 Përgjigje në kërkesë

20 Marrëveshje të bashkëpunimit

1200 interpretime ligjore.

Zyra Avokatit Publik të Komunës

Për vitin-kohën tani për të cilën po raportojmë, janar-dhjetor 2021, avokati publik i komunës ka kryer këto punë:

Lëndët e regjistruara gjyqësore për vitin-kohën tani që po raportojmë, të të gjithave procedurave gjyqësore janë **31 lëndë të regjistruara**, **18 lëndë** janë lëndë nga procedura civile në procedurë kontestimore të natyrave të ndryshme, **3 lëndë** janë të procedurës jashtëkontestimore, **10 lëndë** janë të procedurës penale, për të cilat lëndë janë ushtruar kallëzime penale, të cilat sipas detyrës zyrtare I udhëheqë prokurori i shtetit,

Prej lëndëve kontestimore në procedurën civile të cilat në numër janë **18**, ku avokati kundër këtyre lëndëve ka ushtruar **11** përgjigje në padi, kundër paditësve, dhe 7 padi. Të gjitha këto lëndë janë duke u zhvilluar në procedurë gjyqësore. Ndërsa nga lëndët e bartura nga vitet paraprake të cilat janë ende në procedurë. Prej këtyre lëndëve të bartura për të cilat janë mbajtur shumë seanca gjyqësore me vite në këtë periudhë që tani po raportojmë janë përfunduar me aktvendim, aktgjykim të formës së prerë nga Gjykata e Apelit e Republikës së Kosovës dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës me mjete të jashtëzakonshme, me Revizion janë përfunduar 5 lëndë në favor të Komunës së Vitisë, ku vlera e tyre është 100.000 mijë €, ndërsa 18 lëndët kontestimore civile të cekura më lartë për periudhën tani që po raportojmë, janar - qershor për 2019 këto lëndë janë të gjitha në procedurë gjyqësore, janë në procedurë, disa janë duke u zhvilluar me mjete juridike të **rregullta**, me ankesë ku kemi ushtruar 6 ankesa, disa janë në procedurën e përmbarimit, ku kemi 14 prapsime, dhe si dhe mjete të **jashtëzakonshme** në instancat më të larta gjyqësore. Ndërsa 10 lëndët penale për veprat penale për uzurpime të pronës komunale-shtetërore nga neni 332 parag.1 i KPRK-ës, që sipas detyrës zyrtare i udhëheq Prokurori i Shtetit të gjitha këto janë në procedurën e shqyrtimit gjyqësorë, ndërsa lëndë penale të bartura nga vitet paraprake në vitin 2021 janë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë 3 lëndë siç e cekem edhe më lartë.

Për periudhën që tani po raportojmë, Avokati publik ka pranuar nga gjykatat tona edhe 6 lëndë kontestimore me padi, ku paditësit janë punëtorët e pensionuar gjatë viteve paraprake ku të njëjtit me kërkespadi korrin pas pensionimit, edhe nga 6 paga tri paga jubilarë dhe tri paga përcjellëse pas pensionimit duke u bazuar në marrveshjen kolektive të vitit 2014 e cila ka hyr në fuqi janar 2015. Me qenë Komuna e Vitisë nuk ka mjete të ndara nga Qeveria e Kosovës për këto pagesa pas pensionimit të pontorëve të saj. Andaj Avokati i Komunës duke u bazuar në këto arsye ne kemi ushtruar 6 përgjigje në padi të natyrës së këtyllë duke i kundërshtuar nga arsyet e sipërcekura, i të gjitha këto lëndë janë në procedurë gjyqësore. Lëndët civile që kanë të bëjnë me kontestet e punës të regjistruara janë 2, lëndë e që janë në procedurën gjyqësore, ku Komuna e Vitisë paraqitet si paditëse në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ. Sa i përket mjeteve të jashtëzakonshme, revizioni, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe propozimi për përsëritjen e procedurës, qoftë në procedurë penale apo civile, të cilat ushtrohen vetëm kundër aktvendimeve, aktgjykimeve të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës. Komuna e Vitisë për këtë që po raportojmë ka ushtruar 2 revizione, 1 përgjigje në revizion për të cilat ende nuk kemi vendime, aktgjykime nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

Meqenëse nëpër gjykatat tona ka shumë lëndë të viteve paraprake të cilat kërkojnë zgjidhje, ende nuk janë treguar edhe përkundër disa parastresave të ushtruar nga avokati i komunës për disa lëndë të cilat janë me prioritet, por ende nuk kemi ftesa për shqyrtim kryesor.

Zyra për Integritet Evropian

Zyra Komunale për Integritet Evropian, zyrtari për integritet evropian, gjatë periudhës janar – dhjetor 2021, ka kryer këto aktivitete:

1. Kemi profilizuar Planin Kombëtar për Integritet Evropian 2021 dhe iu ka rekomanduar Zyrës së Kryetarit të Komunës, Zyrës së Kryesuesit të Kuvendit, drejtorive komunale dhe zyrave ndihmëse të

kryetarit të komunës për plotësimin e objektivave që dalin nga Plani Kombëtar për Integritet Evropian 2021.

2. Kemi mbajtur takim njoftues me Zyrën e Kryetarit të Komunës, Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit,

3. Kemi marrë pjesë në takimin e Kolegjiumit të ZKI-ve, me AKK dhe MAPL-në.

4. Kemi përcjell punimet e takimeve të KPF-së.

5. Kemi përcjell punimet e seancave të Kuvendit të Komunës .

6. Kemi marrë pjesë në komisionin për riintegrim, në bordin e drejtorve.

7. Takime me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare për instrumentet financiare të BE-së, informata për TAEX

Zyra për Projekte

Bazuar në detyrat e punës nga Zyra e Kryetarit të Komunës dhe kërkesat e Zyrës së Projekteve gjatë periudhës janar- dhjetor të vitit 2021, kemi punuar në hartimin e projekteve, raporteve të pranimi të tyre dhe mbikëqyrjes së zbatimit të projekteve.

Përveç hartimit të projekteve të lartpërmendura, kemi kryer edhe këto punë, si:

- hartimin e detyrave projektuese,
- Pranimin teknik të hartimit të projekteve të ndryshme,
- Pranimin teknike të projekteve të përfunduara,
- Komisione të ndryshme për vlerësim,
- Menagjimi i zbatimit të projekteve,
- Angazhime tjera shtesë sipas kërkesave të menagjimentit.

KAPITULLI III

Raportet e Drejtorive

Drejtoria për Administratë

Misioni i Drejtorisë për Administratë është zbatimi Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, ligjeve tjera që aplikohen në Administratë, Udhëzimet Administrative të nivelit qendror, Statutit të Komunës së Vitisë dhe akteve tjera komunale të aprovuara nga Kuvendi i Komunës.

Drejtoria e Administratës, kryen shërbime të përgjithshme administrative për organet e administratës dhe ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët e Komunës së Vitisë.

Shërbimet e përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera të kësaj drejtorie përfshijnë:

Ofrimi i shërbimeve dhe kryerja e punëve administrative mbështetëse për punën e Kuvendit të Komunës, trupave të Kuvendit të Komunës dhe Këshillit të drejtorëve.

Përgatitja e akteve të cilat i nxjerr Kryetari i Komunës, Këshilli i Drejtorëve.

Harton propozim rregullore, propozim vendime në fushën e Administratës.

Kujdeset për përkthimin e materialeve të Kuvendit, trupave të kuvendi dhe Këshillit të drejtorëve duke respektuar gjuhët zyrtare.

Drejtoria e Administratës, ka realizuar objektivat të cilat dalin nga Plani i Punës së Drejtorisë për vitin 2017.

Drejtoria për Administratë ka hartuar planin e veprimit për muajt Korrik dhe Gusht 2017 për arsye të kryerjes së shërbimeve administrative për bashkatdhetarët që vijë nga bota e jashtme për pushime verore.

Në vazhdim do të paraqesim punën e sektorëve të kësaj drejtorie.

I. Sektori për punë administrative

Sektori për punë administrative ka kryer punët dhe detyrat e punës për nevojat e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Kryetarit të Komunës, Këshillit të Drejtorëve dhe drejtorit të Drejtorisë për Administratë.

Ky sektorë ka përgatit ftesat dhe materialet tjera për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Këshillit të Drejtorëve, Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, etj. Kuvendi i Komunës ka mbajtur 9 seanca të rregullta dhe 3 seanca solemne, dhe 1 inauguruese. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 8 mbledhje të rregullta. Komiteti për Komunitete ka mbajtur 8 mbledhje dhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur 8 mbledhje të rregullta.

Kuvendi i komunës ka miratuar: 4 rregullore, dhe 38 vendime të ndryshme. Të gjitha këto akte normative të Kuvendit janë përgatit për procedurë për nënshkrim dhe protokollim dhe janë dërguar në Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal për vlerësim të ligjshmërisë së këtyre akteve. Janë përgatit 10 procesverbale të seancave të Kuvendit të Komunës, 8 procesverbale të Komitetit për Politikë dhe Financa, 8 procesverbale të Komitetit për Komunitete, dhe 8 procesverbale të KKSB.

Gjatë kësaj periudhe raportuese Këshilli i Drejtorëve ka mbajtur mbledhje konsultative javore dhe mbledhje të rregullta ku janë shqyrtuar materiale të ndryshme të cilat janë përcjellë për shqyrtim dhe aprovim në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin Komunal. Për mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve është përgatit materiali si dhe janë hartuar procesverbale për këto mbledhje.

Për nevojat e Kryetarit të komunës për këtë periudhë raportuese janë hartuar gjithsejtë 163 dokumente: prej tyre 54 vendime, 25 Marrëveshje të ndryshme, kërkesa dhe shkresa të ndryshme. Vendimet e hartuara janë të natyrave të ndryshme: Propozim vendime për kuvend, të ndarjes së ndihmave financiare, vendime për formimin e komisioneve të ndryshme për pranimin e mallit, vendime për caktimin e menaxherit për mbikëqyrjen e punëve, vendime për pranimin teknik të punëve, etj.

Zyrtari për përkthim ka përkthye në mënyrë simultante në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, Komitetit për Politikë dhe Financa, Këshillit për Siguri në Bashkësi, Komitetit për Komunitete dhe Këshillin e Drejtorëve. Gjithashtu ka përkthye edhe të gjitha materialet të cilat kanë dal nga mbledhjet e Kuvendit, KPF, KKS, Komitetit për Komunitete dhe Këshilli i Drejtorëve.

II. Sektori i gjendjes civile

Në vazhdim po e paraqesim numrin e dokumenteve të lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile për periudhën Janar – Dhjetor 2017:

Nr	Përshkrimi i Lëndëve	totali
1	Ekstrakt lindje	19352
2	Çertifikata lindjes	9587
3	Çertifikata martesës	5885
4	Çertifika e vdekjes	2207
5	Çertifikata vendbanimi	1043
6	Çertifikata e bashkësisë familjare	3265
7	Çertifikata e statusit Martesor	1219
8	Çertifikata e shtetësisë	298
9	Vërtetim nga Arkivi	949
10	Vendimet	182
11	Aktvdekjet	218
12	Vërtetimi mjeteve	99
13	Vizita	409
14	Regjistrimet në LAL të jashtme	497
15	Regjistrimet në LAL të brendshme	253
16	Regjistrimet në LAV (vdekje të jashtme)	63
17	Regjistrimet në LAV (vdekje të brendshme)	253
18	Regjistrimet në LAM të jashtme	149
19	Kurorëzime të reja	448
20	Shkurorëzime	80
21	Humbje shtetësi	54
22	Fitim shtetësie	14
23	E-kioska	0
	Totali	45846

Numri i përgjithshëm dokumenteve të lëshuara për periudhën Janar – Dhjetor 2021 është **45846** dokumente. Numri i qytetarëve të cilët janë futur në sistemin e Gjendjes Civile në Komunën tonë është **55806**.

III. Sektori i zyrës pritëse dhe arkivit

Zyra Pritëse dhe Arkivit në kuadër të aktiviteteve të saj të cilat i ka kryer për këtë periudhë raportuese për vitin 2017 janë si: regjistrimin e të gjitha kërkesave dhe parashtresave, shërbimet postare për organet e administratës komunale, ofrimin e ndihmës juridike qytetarëve për plotësimin e kërkesave, dhe regjistrimin e kërkesave në protokoll.

Numri i kërkesave të pranuar në zyrën pritëse është paraqit në formë tabelare.

Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Vdekurve - LAV nga jashtë 209
Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Martuarve - LAM nga jashtë 272

Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Lindurve - LAL nga jashtë 880
Numri i kërkesave në zyrës pritëse nga Shtetet e jashtme, si: LAL, LAM dhe LAV
TOTALI - 1361
Deklaratat e nxjerra pran zyrës pritëse:
Deklarata për vendqëndrim 24
Deklarata për trashëgimi 287
Deklarata për përkujdesje financiare 122
Deklaratë për regjistrimin në LAL 81
Deklarata për regjistrim në LAV 249
Gjithsejtë:763

LËNDËT E ARKIVUARA

Drejtoritë	Nr. i lëndëve të arkivuara
Drejtoria për Shërbime Publike dhe emergjencë	223
Drejtoria për Administratë	42479
Drejtoria për Arsim	142
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	170
Drejtoria për Financa Ekonomi, dhe Zhvillim	1531
Drejtoria për Kulturë , Rini dhe Sport	453
Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mjedisit	130
Drejtoria e Inspeksionit	95
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	642
Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër	7305
Kuvendi i Komunës	11
Zyra e Kryetarit	161
Zyra për Komunitete	41
Totali	54644

IV. Sektori i administrimit

Ky sektor përfshin shërbimet që kanë të bëjnë me mbështetjen logjistike të organeve të administratës dhe atë: Kujdesit për mirëmbajtjen e auto veturave zyrtare të organeve të administratës, sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve komunale.

Vërejtje: Për pune me efikase dhe menaxhim me te suksesshëm ne këtë sektor duhen te behet renovimi i objekteve komunale, autoparkut, dhe krijim i hapësirave të nevojshme për punë.

Në vazhdim po i prezantojmë shpenzimet e mirëmbajtjes, karburanteve dhe shpenzime tjera për automjete dhe gjeneratorë për periudhën Janar –Dhjetor 20121:

Shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve dhe gjeneratorëve për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë për periudhën raportuese janë 3788,00 euro.

- Administrata.....15.953,00€,
- Shëndetësia13.693,00€ dhe
- Njësia e zjarrfikëseve.....5.638,00€

Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, gjenerator, nxehje qendrore dhe autorizime për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë janë 64836 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë janë: 43.384 litra

- Administrata.....15.635 litra,
- Shëndetësia15.298 litra dhe
- Njësia e zjarrfikës.....12.451 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për nxehje qendrore për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë janë 18.511 litra naftë,

- Administrata.....20.518 litra
- Shëndetësia2.610 litra,
- Njësia e zjarrfikësve 0 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për gjenerator për të gjitha njësit shpenzuese janë:3185 litra.

- Administrata.....1153 litra,
- Shëndetësia..... 695 litra,
- Njësia e zjarrfikësve..... 234 litra.
- DKA-ja (shkollat).....1103 litra

Sigurimet e automjeteve zyrtare te Komunës se Vitisë 8.533.09€

Zyra e IT-së ka udhëhequr dhe kontrolluar punën e sistemit të teknologjisë informative me qëllimin e zbatimit të standardeve dhe ofrimin e shërbimit më cilësor, në veçanti:

- Ka zbatua hardware, Softwerin Kompjuterik dhe të qasjes me internet
- Mirëmbajtjen e infrastrukturës për internet dhe kyçe sipas nevojave të ndryshme për organet komunale.
- **Mirëmbajtja e Serverit çdo ditë**
- **Mirëmbajtja e Intranetit çdo ditë**
- **Mirëmbajtja e webfaqes çdo ditë**
- **Mirëmbajtja e Gjendjes Civile çdo ditë**
- **Mirëmbajtja e-pasurisë çdo ditë**

Zyrtari për pranimin e mallit, gjatë periudhës Janar-Qershor 2017, ka punuar në harmoni me përshkrimin e vendit të punës, ku ka realizuar objektivat që parashihen me planin e punës gjatë kësaj periudhe.

Pranues i mallrave ka kryer këto detyra të punës:

- Pranimin e mallrave në Sistemin e Menaxhimit të Financave në Republikën e Kosovës (free balance), ku ka kryer mbi 350 lëndë ku vlera e tyre kap shumën 450,000,00€, për periudhën Janar-Qershor;
- Pranimin dhe regjistrimin e mallrave në Sistemin e menaxhimit të Pasurive (E-Pasuria), ku në të përfshihen materialet shpenzuese si dhe asetet komunale ku vlera e këtyre materialeve është mbi 12.000,00€apo diku rreth 35 lëndë;
- Ka plotësuar mbi 50 formularët për kërkesën e furnizimit me material për zyre dhe inventarë;
- Ka bërë furnizimin me material shpenzuese si dhe inventarë për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë duke e përfshirë Zyrën e Kryetarit dhe gjitha Drejtorit tjera dhe komunitetet;
- Furnizimin me Inventarë dhe material shpenzues për të gjitha Shkollat e Komunës së Vitisë;
- Ka përgatitur disa paramasa për furnizime me material shpenzuese,

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

I. Aktivitetet e kryera:

- Janë regjistruar 2016 kupona të shpenzimeve në SIMFK (Sistemi i Menaxhimit të Financave të Kosovës) përmes transferit me procedurë të prokurimit.
- Janë çertifikuar 2016 pagesa përmes transferit me procedurë të prokurimit.

- Gjatë kësaj periudhe, në programin e administratës komunale dhe arsimit parauniversitar janë dorëzu në MAP – divizioni i pagave (punëtorë të ri, largime dhe ndryshime) ndryshimet, nga QKMF-ja kopje të pranuar të cilat janë përfshirë në evidencën e përgjithshme.
- Është bërë barazimi i të hyrave vetanake në baza mujore në mes të hyrave të arkëtuara dhe të hyrave të paguara.
- Janë pranuar, evidentuar, protokollu 772 fatura, kontrata, vendime dhe të njëjtat janë dorëzu për zotim dhe vijim të procedurës të mëtejme deri te ekzekutimi.
- Janë pranuar 164 raporte nga drejtorit që inkasojnë të hyra vetanake në vlerë nën 10 euro dhe janë bërë 36 depozime në bankë.

II . Sektori i buxhetit dhe thesari

- Regjistrimi i obligimeve të pa paguara për periudhën janar-dhjetor 2021;
- Përgatitja e pasqyrave financiare për periudhën TM-1, TM-2 dhe TM-3;
- Sistemitimi i të gjithë punëtorëve në sistemin e pagave nëpër të gjitha programet sipas planifikimit të buxhetit vitit 2021;
- Janë përgatit të gjitha deklaratat e disponueshmërisë së mjeteve për pagesë të projekteve duke u bazuar në planifikimin e buxhetit e vitit 2021;
- Dhënia e informacioneve për të gjithë udhëheqësit e programeve buxhetore mbi gjendjen e rrjedhjes së parasë së gatshme për tërë vitin 2021;
- Barazimi i regjistrave të pasurive mbi dhe nën 1.000 euro, të regjistruara në frebalanc/E pasuria si dhe regjistrimi në regjistrin intern;
- Janë bërë zotimet e mjeteve për të gjitha programet buxhetore dhe kategoritë ekonomike, varësisht nga kërkesat e autorizuesve të buxheteve përkatëse;
- Përpilimi i raportit të shpenzimeve për MF për TM-1, TM-2, TM-3 2021;
- Raportimi i obligimeve të pakryera në MF, në departamentin e thesarit për çdo muaj dhe është bërë përgatitja e pasqyrave financiare për TM-1, TM-2 dhe TM- 2021;
- Përgatitja e qarkores së parë interne komunale 2022/01, e datës 15.05.2021, për të zhvilluar procesin buxhetor komunal 2022-2024;
- Përgatitja e Kornizës Afatmesme të Buxhetit (KAB) komunal për vitin 2022-2024 të datës 21.06.2021;
- Konsultimi i vazhdueshëm me drejtorët e drejtorive rreth inicimit të shpenzimeve të ndryshme komunal.

III. Sektori i Tatimit në Pronë

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2021 janë kryer këto punë:

- Afrimi i shërbimeve për qytetarët e komunës për kryerjen e obligimit të tatimit në pronë;
- Afrimi i shërbimeve për qytetarët e komunës për pagesën e taksës komunale për automjete;
- Lidhja e marrëveshjeve me tatimpagues për pagesën e detyrimit tatimor sipas kushteve të parapara nga DFEZH dhe dhënia e këshillimeve palëve për kushtet e pagimit të tatimit në pronë;

- Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2021 janë shërbyer 11519 palë me vërtetime (struktura: 8091 vërtetime për regjistrim të automjeteve, 189 vërtetime për raste sociale dhe 3428 vërtetime për nevoja të Katastrit);
- Është kryer shpërndarja e mbi 11327 fakturave për çdo qytetar në Komunën e Vitisë;
- Gjatë periudhës janar- dhjetor të vitit 2021 janë inkasuar 477,216.22euro nga tatimi në pronë dhe 95,410.00 euro nga taksa komunale për automjete;
- Realizimi i planit për tatimin në prone shprehur në përqindje është realizuar 108.56 % kurse taksa komunale për automjete është realizuar 119.26%;
- Kemi përgatitur një plan të veprimit nga një komision kompetent për rritjen e shkallës së inkasimit të tatimit në pronë;
- Është përpiluar lista e borxheve të qytetarëve sipas fshatrave dhe paraqitja e përqindjes së realizimit të obligimeve për çdo lokalitet.

IV. Sektori për ekonomi dhe zhvillim

- Kemi bere dorëzimin e raportit te punës për vitin 2020 dhe planin e punës për vitin 2021;
- Kemi bere shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve për marrjen e pëlqimeve për shfrytëzimin e parcelave te Agjensisë Pyjore dhe te pronave nen menaxhimin e AKP-së.
- Kemi bere kërkesat pranë Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit për marrjen e lejeve të kërkuara nga Zyra e Projekteve.
- Me kërkesë të MTI-së, përkatësisht Divizioni I Turizmit, ne bëmë grumbullimin informative gjegjësisht bëmë identifikimin e produktit turistik për rajonin e Anamoravës - Komuna e Vitisë.

V. Projektet e investimeve kapitale për vitin 2021 të financuara nga buxheti i Komunës së Vitisë dhe buxheti i nivelit qendror

1	Asfaltimi i rrugës Viti-Smirë sipas dinamikës në përfundim	62,000.00
2	Asfaltimi i rrugëve rurale ne realizim e sipër neper vendbanime te Komunës	622,812.75
3	Rregullimi i gypit te ujësjellësit ne Letnicë	10,442.58
4	Rregullimi i kanalizimeve	150,000.00
5	Rregullimi i rrugëve me zhavor	201,390.75
6	Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik	301,096.80
7	Rregullimi i hapësirave gjelbëruese – publike	73,178.00
8	Rregullimi i fushave sportive	169,942.50
9	Rregullimi i lumenjve (kanaleve) dhe prrockave	70,000.00
10	Ndërtimi i urave ne Pozheran, Buzovik dhe Pozheran	65,000.00
11	Fusha ndihmëse e futbollit ne Pozheran	70,011.45
12	Riparime nëpër shkolla	120,000.00

13	Renovim i ambulancave në proces te prokurimit	97,493.00
14	Rregullimi i rrugës Viti – Sllatine e Ultë	117,398.50
15	Ndërtimi i ambulantes në fshatin Terpezë	20,000.00
16	Furnizimi me aparatura dhe digjitalizim	22,000.00
17	Rregullimi i hapësirave në QKMF	8,000.00
18	Rregullimi i rrethojave te Ambulancave	7,000.00
19	Rregullimi i nxemjes qendrore ne Ambulanta	15,000.00
20	Rregullimi i stadionit ne Pozheran ne fazën e përfundimit te projektit	179,700.00
21	Rregullimi (asfaltimi) rrugës alternative te Stublles ne proces tenderimi	474,495.00
22	Ndërtimi i çerdhes se fëmijëve ne Qifllak	66,000.00
23	Ndërtimi i shkollës fillore në Pozheran në proces të përfundimit	250,000.00
24	Palestra e sporteve ne Drobesh (Punimi i konstruksioni te kulmit me kapriate) ne proces te realizimit	150,000.00
25	Renovimi objektit për Muzeun e qytetit	31,600.00
26	Rregullimi i rrugës Viti-Korbeliq-Kaçanik	150,000.00
27	Rregullimi i rrugës së Mjakut dhe Dobelldehut ne proces te prokurimit	10,000.00
28	Ndërtimi i infrastrukturës ne parkun industrial Budrikë, në fazën përfundimtare	803,621.00
29	Ndërtimi i stadionit ne Viti është i përfunduar	100,000.00
	Totali i investimeve	4,239,089.33

VI. Zyra për regjistrimin e bizneseve

- Gjatë periudhës janar- dhjetor 2021 janë regjistru 187 biznese të reja;
- Gjatë kësaj periudhe janë shuar 21 biznese;
- Numri i përgjithshëm i të punësuarve është 230 punëtorë.

Drejtorja për Inspeksion

Ky raport paraqet aktivitetet e Drejtorisë së Inspeksionit (në vazhdim D.I.) për periudhën kohore janar-dhjetor 2021, të cilin ju përcjellim zyrës së kryetarit të komunës së Vitisë, ashtu siç kërkohet, raporti është i ndarë ashtu që është bërë prezantimi i mandatit, kompetencave dhe përgjegjësi të D.I. Raporti i punës së

D.I për vitin 2021, përmban të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës kohore për të cilën raportohet, Po ashtu, në raport është dhënë një përmbledhje e pasqyrës së pajtueshmërisë së inspektimeve dhe shërbimeve me ligjin dhe të gjitha aktet nënligjore të D.I.

Aktivitetet e Drejtorisë së Inspeksionit (D.I.)

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 janë kryer punët dhe detyrat nën mbikëqyrjet inspektuese si vijon:

- Kompletimin e lëndëve në lëminë e uzurpimeve të tokës në pronësi publike-komunale.
- Lirim të pronës së uzurpuar publike dhe lirim të hapësirave publike me qëllim të relizimeve të investimeve në infrastruktur publike nga ana e institucione kumunale.
- Inspektimet rreth mbrojtjes nga pandemia COVID-19 sipas Manualit të IKSHP, Ligjit për mbrojtje të sëmundjeve ngjitëse dhe Vendimeve të Qeverisë së Kosovës.
- Inspektimi i kualitetit të ushqimit, të produkteve të ambalazhuara dhe të paambalazhuara, rreth higjienës dhe kushteve higjieno-sanitare, zbatimit të Ligjit të duhanit etj.
- Inspektimet lidhur me tregtimin me pakicë, pajisjen e subjekteve afariste me certifikata të biznesit si dhe inspektimet mbi blerjen, shitjen, çmimet, deklaracionin e mallit, mbrojtjen e konsumatorit, zbatimin e orarit të punës etj.
- Inspektimet e ndërtimit në sektorin publik dhe privat rreth punimeve dhe pajisjes me leje të ndërtimit, si dhe ndalimi i punimeve të objekteve pa leje dhe marrja e masave të nevojshme.
- Inspektimi rreth ndotësve të ambientit, inspektimi i tregjeve, rrugëve, trotuareve, e sidomos inspektimi rreth ujërave të zeza në zonat rurale.
- Inspektimi i kompanive të transportit në komunikacionin rrugorë, orari i udhëtimit, lejet e operimit, rendet e udhëtimit, stacionet, parkingjet etj.
- Janë kryer edhe punë tjera sipas kërkesave dhe obligimeve ligjore për inspektime në teren.

Sektori për Inspektime

Ky sektor në kuadër të drejtorisë për inspeksion udhëhiqet nga Udhëheqësi për inspektime, ku përfshin inspektimet për shërbime publike, ambient dhe komunikacion si dhe uzurpimet e pronës komunale dhe i cili në kuadër të plan-programit të punës dhe autorizimeve që ka sektori i njeiti ka udhëheqë, mbykëqyrë dhe organizuar punët dhe inspektimet në përputhje me dispozita ligjore pozitive.

Janë kryer edhe punë tjera të cilat janë dhe kanë qenë me interes për Drejtorinë tonë, si dhe per organet e tjera komunale, bashkëpunimi, organizimi dhe kordinimi i sektorit me drejtoritë: kadastrit, pronës dhe gjeodezisë, shërbime publike dhe drejtoritë komunale tjera si dhe bashkëpunimi me institucionet qendrore, ka vazhduar transformim i sektorit në ngritjen e efikasitetit të punës dhe profesionalizmit, përcjelljen e infrastrukturës ligjore në fushat e këtij sektori etj.

Raportet individuale të sektorit për inspektime përfshin inspektimet për shërbime publike, ambient dhe komunikacion.

Inspektori i mjedisit

Në lëmin e mjedisit gjatë kësaj periudhe Inspektori i mjedisit ka qenë i angazhuar rreth mbrojtjes se mjedisit nga ndotja, mbeturinat, zhurma e me theks të veçantë inspektimi rreth ujërave të zeza sidomos në zonat rurale sipas kërkesave të qytetarëve, pastaj hyrja e qytetarëve në sistem të menaxhimit të mbeturinave. Gjatë kësaj periudhe është bërë:

- Inspektimi i hedhjes së mbeturinave afër rrugëve, vendeve publike;
- Inspektimi i largimit të mbeturinave inerte në vendet ku ka pasur ndërtime;
- Inspektimet e operatorëve të cilët veprojnë në Komunën e Vitisët e që janë ndotës të mjedisit;

- Inspektimet sipas kërkesave të qytetarëve rreth kanalizimeve, ujërave të zeza, plehrave, etj, sidomos në zonat rurale.

Inspektori i shërbimeve publike

Kemi bërë inspektimin e hapësirave publike me qëllim të mbajtjes së pastërtisë së hapësirave nga afaristët dhe kompania e pastrimit. Inspektimi është periodik dhe gjendja ka qenë e kënaqshme me disa vërejtje verbale. Vëzhgimi i pastrimit të hapësirave publike nga bora. Pastaj vëzhgimi i reklamave si dhe vendosja e tyre në vendet e posaçme të lejuara. Vëzhgimi i mjedisit dhe hapësirave publike në teren të Komunës së Vitisë. Evidentimi i dëmtimeve të hapësirave publike. Përpilimi i procesverbaleve në lidhje me dëmtimet. Evidentimi i vendosjes së reklamave në hapësira publike. Kemi bërë inspektimin e bizneseve që shfrytëzojnë hapësirën publike në përputhje me obligimet a dispozitave ligjore. Inspektimet në tregjet Drobesh, Viti dhe Pozheran, vlerësimet në suaza normale. Kemi bërë inspektimin e hapësirave publike, gjithashtu në suaza normale të mbikëqyrura nga bizneset shfrytëzuese janë në gjendje të kënaqshme. Kemi kryer edhe detyra tjera në dobi të Drejtorisë së Inspeksionit.

Inspektori i komunikacionit

Inspektori i Komunikacionit është angazhuar konform Ligjit për Transportin Rrugor Nr.04/L-179, Ligji i Transportit për Mallra të Rrezikshme Nr.2004/6, Ligji i Trafikut Nr.05/L-088 dhe Rregullores për organizimin e transportit brenda territorit të Komunës së Vitisë si dhe aktet tjera në fuqi nga lëmia përkatëse. dhe për transportin rrugor në territorin e Komunës së Vitisë ku problem i vazhdueshëm është edhe më tutje i kombi-taxive që operojnë në mënyrë ilegale. Janë inspektuar Operatorët Ekonomik-autobusët rreth respektimit të rendin të udhëtimit sipas Ligjit për transportin rrugorë Nr.04/L179.

Nga kjo lëmi është punuar me sa vijon:

- Inspektimi në komunikacionin rrugor të udhëtarëve të operatorëve ekonomik (autobusët, kombinueset, autotaxit);
- Inspektimi i pajisjes së transportuesëve me leje operimi, orar të udhëtimit.
- Inspektimi në stacionin e autobusëve, rrugë etj, sipas kërkesave dhe në bashkëpunim me Policinë e Kosovës-Njësi në Viti;
- Gjithashtu kemi koordinuar dhe harmonizuar të gjitha linjat Urbano-Periferike me Autobus, ku kemi një transport publik të kënaqshëm, në të gjitha linjat;
- Në kudër të kompetencave dhe përgjegjësi tona, kemi kontrolluar të gjitha rrugët publike ku në disa raste kemi intervenuar në sanimin e gjendjes apo dëmtimeve të rrugës , mbylljen e kanaleve të hapura, apo mënjanimin e pengesave në rrugë pa ndo një leje përkatëse;
- Gjithashtu kemi lejuar vendosjen e Pengesave të ashtu quajtura (Polic i shtrirë) në Kabash, Smirë, Beguncë, Ramnishtë etj;
- Gjithashtu edhe kemi mënjeluar shumë pengesa si në Viti, Beguncë, Lubishtë etj;
- Në kuadër të furnizimit dhe vendosjes së shenjave Vertikale dhe Horizontale të Komunikacionit, në bazë të planit paraprak mbi kontratën për shërbime kemi furnizuar me shenja Vertikale dhe Horizontale të gjitha rrugët e qytetit të Vitisë, Rrugën Viti-Pozheran, Viti-Smirë, Viti-Ramnishtë-Beguncë, Skifteraj, Tërpezë, Remnik, Ramjan, Pozheran , Vërban, etj;
- Kemi shënuar të gjitha vendkalimet për këmbësor, dhe vijat ndarëse të mesit të rrugës dhe kemi sinjalizuar me shenja horizontale si vendkalime edhe rrugët Rajonale në Pozheran, Ramjan dhe Radivojc;
- Linjat urbano-periferike për vitin 2021 në komunën e Vitisë. Gjithsej i kemi të mbuluara 28 vendbanime me 44 vendndalje për transport publik. Nga këto vendndalje 10 janë të shenjëzuara në rrugët rajonale, ndërsa të tjera janë të pashenjëzuara.

Inspektori I ndërtimit

Nga lëmia e Ndërtimtarisë janë përcjellë në vazhdimësi ndërtimet rreth lejeve të ndërtimit dhe tërë dokumentacionin e nevojshëm ndërsa për shkelësit e ligjit janë marrë masat e nevojshme. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë inspektuar objekte të ndërtimit të kategorisë së I dhe të II. Për të gjithë ata që nuk kanë respektuar urdhrat e inspektorit janë marrë masa ndëshkuese si gjoba mandatore dhe kallëzime penale, mungesa e një inspektori të ndërtimit ka paraqitur pengesa dhe ngecje në lealizimin e objektivave, sa i përket ndërtimeve pa leje përkatëse.

Gjatë kësaj periudhe janë bërë:

- Inspektimi i ndërtimeve në sektorin publik dhe privat që përfshinë ngritjen, instalimin, renovimin, zgjerimin, ndryshimin apo adaptimin e të gjitha strukturave ndërtimore;
- Inspektimi i lejeve të ndërtimit;
- Inspektimi i kushteve urbanistike (leja urbanistike);
- Inspektimi i dokumentacionit teknik (projektet ndërtimore, lejet ndërtimore);
- Lëshimi dhe modifikimi i sanksioneve dhe përgatitja e vendimeve për ndërprerjen e ndërtimeve ilegale.

Inspektorati I tregut

Nga lëmia e tregut dhe çmimeve për periudhën janar - dhjetor 2021 nga dy inspektorët e tregut është bërë inspektimi mbi certifikimin e ushtrimit të biznesit, licencat, çmimet e mallrave të ekspozuara, mbarëvajtja e tregut në Viti, orari për fillimin dhe mbarimin e punës së lokaleve, matjet dhe verifikimi e peshës së bukës, deklaracioni i mallit si dhe punëve tjera nga kjo lëmi.

Inspektimet e subjekteve afariste rreth regjistrimit të bizneseve dhe të cilat realizohen nga dy inspektor.

- Kontrolle rreth zbatimit zbatim të ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut nr. 03/L-181 dhe të orarit të punës, deklaracionit të mallit dhe kontrollit të çmimit të artikujve;
- Inspektimi i sigurisë së produkteve ushqimore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve;
- Inspektimet e herëpashershme sipas kërkesave dhe në bashkëpunim me ministrinë përkatës në bazë të Ligjit të Tregtisë së Brendshme etj;
- Inspektime në aspektin e vendosjes së flamurit pranë artikujvel
- Kontrolle mbi kualitetin, cilësinë dhe sigurimin e produkteve në qarkullim të mallrave.

Inspektorati sanitar

Nga lëmia e Inspektorit Sanitar (që përfshin periudhën deri sa ka kaluar në kuadër të AUV) është bërë inspektimi rreth parandalimit dhe luftimit të sëmundjeve ngjitëse COVID-19, higjienës së ujit, Institucioneve shkollore, artikujve ushqimor, hoteleve, kuzhinave ushqimore si dhe higjiena e objekteve tjera afariste.

- Inspektimet rreth parandalimit COVID-19 ku janë;
- Inspektimet rreth higjienës, kontrollës së përgjithshme të artikujve ushqimorë dhe produkteve të përdorimit të përgjithshëm (marketet, subjektet afariste hoteliere, sallonet e ondulimit etj);
- Inspektimet rreth zbatimit të Ligjit për kontroll të duhanit dhe marrja e masave për shkelësit e këtij Ligji;
- Inspektimi i ujit të pijes sipas kërkesave të qytetarëve;
- Kontrolle rreth librezave sanitare;
- Inspektime të ndryshme nga inspektori sanitar nëpër shkolla, ambulanta, pishina atj.

Inspektorati i veterinës

Nga lëmia e Inspektorit të Veterinës dhe Bujqësisë (që përfshin periudhën deri sa ka kaluar në kuadër të AUV me datë 01.08.2021) përfshinë:

- Inspektimi i vazhdueshëm nëpër thertore dhe mishtoreve;
- Inspektimi i marketeve dhe bizneseve;

- Inspektimi nëpër fshatra për dele, dhi dhe qeneve endacak etj, si dhe marrja e masave ndaj tyre;
- Marrja e mostrave për s'mundje infektive për bletë dhe dhi etj, si dhe asgjësimi tyre;
- Inspektimi për lopë dhe shpeztari etj.

Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2021 në kuadër të drejtorisë së Inspeksionit janë realizuar:

- Inspektime.....	663
- Procesverbale.....	407
- Vendime për izolim (COVID-19.....)	812
- Vendime për ndërprerje të punimeve.....	22
- Pëlqime sanitare.....	12
- Kontroll objekteve shkollore, shëndetësore dhe pishinave.	12
- Kallëzime penale.....	04
- Kërkesa për kundërvajtje.....	01
- Kërkesa për pranime teknike të lokaleve	28
- Mbyllje të lokaleve	5
- Kontrollime dhe asgjësim të mallit	14
- Mostra të ushqimeve	04
- Kontrollime të mjeteve të transportit publik dhe mallrave..	68
- Minitorim të vorrimeve nga Covid-19	12
- Asgjësim të artikujve ushqimor	28.500 kg
- Shuma e mjeteve të grumbulluara nga taksa komunale dhe gjobat në kuadër të D. së Inspeksionit është.....	3.495,00 €

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë gjatë periudhës raportuese Janar–Dhjetor 2021, ka pasur shumë detyra, obligime dhe përgjegjësi sipas planit të punës, të cilat i ka kryer me sukses. Gjatë kësaj periudhe, ne si Komunë jemi ballafaquar edhe me pandeminë COVID-19, edhe pse me kushte të vështirësuar, mirëpo drejtoria jonë ka punuar me kapacitete të plota në ofrimin e shërbimeve komunale.

1. Sektori i shërbimeve publike

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2021, ky sektor ka pranuar gjithsej 348 kërkesa të protokolluara të natyrave të ndryshme, të cilat i kemi kryer në afatin ligjor. Kemi lëshuar vendime të ndryshme, leje për parkim, vazhdimi i lejeve për auto-taxi dhe ngarkesa për shfrytëzimin e hapësirave publike për vitin 2021, si dhe janë bërë pagesa për shfrytëzimin e hapësirave publike, vendosjen e reklamave etj.

Gjatë kësaj periudhe kemi përcjell punët e operatorëve të kontraktuar nga Komuna, të cilit kanë kryer shërbime për komunën.

1.1 Buxheti i drejtorisë së shërbimeve publike dhe emergjencë

DSHPE-ja për vitin 2021, ka pasur buxhetin e aprovuar dhe atë në shumë prej 795.946.85 alokimi I mjeteve është 795.946.85 €, ndërsa është shpenzuar 692.511.66 €, në përqindje 94.00%.

Shpenzimet për komunal.

Për shpenzime komunal kemi të aprovuara 127.000.00 Euro.

Shuma e përgjithshme e shpenzuar për komunal është 120.052.39 Euro, shpenzimi për komunal në përqindje është 95.00 %, duke mos i përfshirë obligimet e muajit dhjetorë të vitit 2021, për PTK, Eco-higjiena, Hidromorava, KES/CO, të cilat barten për vitin 2022.

Shpenzimet për mallra dhe shërbime.

Për mallra dhe shërbime kemi pasur buxhet të aprovuar 665,556.86 Euro, të alokuara 665,556.86 €, të shpenzuara 572,459.27 €, pa i përfshirë edhe obligimet për muajin dhjetor të vitit 2021. Pra, drejtoria gjithsej për mallra dhe shërbime nga mjetet e alokuara ka shpenzuar 94.00%, për vitin 2021, duke mos i përfshirë edhe disa fatura të vitit 2021 të cilat barten në vitin 2022.

Të hyrat vetanake

Tabela e të hyrave vetanake të planifikuara dhe të realizuara 2021

Nr	Përshkrimi i të hyrave	Realizimi vjetor për 2021	
1	Qiraja	8401.60 Euro	
2	Shfrytëzim të hapësirës publike	7374.00 Euro	
3	Reklamat	3520.00 Euro	
4	Taksa për licenca tjera për afarizëm. (leje për autotaksi) dhe shërbime tjera profesionale.	350.00 Euro	
5	Parkimi publik	1375.00 Euro	
	Gjithsej	21,020.60 Euro	

Te hyrat vetanake, te planifikuara kanë qenë per vitin 2021 kanë qenë gjithsejt 24,820.40 Euro, janë të realizuar 21.020.60 Euro, në përqindje janë realizuar 85.00 % të hrave vetanake. Një nder arsyet e mos realizimit te hyrave vetanak edhe shkaku i pandemis Covid -19.

1.2 Mirëmbajtja verore – dimërore e rrugëve lokale

Kemi përcjell punët e kompanis për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve si: Pastrimi i rrugëve lokale nga akulli dhe bora, mbushjen e gropave me asfalt nëpër rrugë të asfaltuara, furnizimin me zhavor nëpër rrugët e rendit të katërt, pastrimi i bankinave të rrugëve lokale nga barojat dhe shkuret, vendosjen e mbrojtëseve ne disa ura etj. Operatori “Zuka Commerce” nga Gjilani, ka kryer shërbimet e kerkuara nga DSHPE dhe per shërbimet e kerkuara kemi shpenzuar per vitin raportues janar-dhjetor 2021 gjithsejt shumën prej 58,9233 Euro.

1.3 Mirëmbajtja e Hapësirave të hapura publike (HHP)

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është bërë pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, hapësirave gjelbëruese, trotuareve, mirëmbajtja e varrezave të dëshmoreve, lumit dhe parkut të qytetit të Vitisë. Ku nga ky projekt janë punësuar edhe 23 punëtorë për gjatë periudhës janar- dhjetor.

Në bazë të kontratës së parë të lidhur mes Komunës së Vitisë dhe kompanisë SHPK „ARBOR GROUP” nga Kamenica me nr. Prokurimi VI657-20882-2-1 nga dt.01.05.2020 -30.04.2021, me vlerë 42.735.00 €, (dyzet e dymijë e shtatëqind e tredhjet e pesë) pastaj është vazhduar edhe me tutje me Aneks Kontratë e që vlera e përgjithshme e shpenzimeve nga muaji janar e deri në muajin dhjetor të viti 2021 për pastrim dhe mirëmbajtja e rrugëve, hapësirave gjelbëruese, trotuareve, mirëmbajtja e varrezave të dëshmoreve, lumit dhe parkut të qytetit të Vitisë ka qenë 116.436.68 € (njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tredhjet e pesë euro).

Janë përcjelle punët për mirëmbajtje dhe pastrim të qytetit dhe HHP, në bazë të kontratës dhe paramasë. Me Hapësira të Hapura Publike (HHP) të përfshira në këtë projekt nënkuptohen të gjitha sipërfaqet publike me rendësi për zhvillimin e jetës shoqërore dhe publike në qytetin e Komunën e Vitisë.

Janë mirëmbajtë: Parqet, Sheshet, Shëtitorja Viti-Bince, Shtrati i lumit Morava, Sipërfaqe gjelbëruese, Hapësirat për parkim automjesh, rrugët në qytet, trotualet në qytet dhe lokalitetet e komunës, tregjet, lapidarë, pllakat për kujtimore, Varrezat e Dëshmorëve dhe varrezat e qytetit të Vitisë. Është bërë edhe krasitja e drunjeve dekorativ në qytet, mbjellja e drunjeve dekorativ, mbjellja e luleve në qytet etj. Me këtë projekt mirëmbahen gjithsej 319.156 metra katror hapësirë publike në qytet dhe lokalitete të Komunës.

1.4 Mirëmbajtja e objekteve të administratës komunale, shëndetësore dhe arsimore

Gjate kësaj periudhe raportuese janë mirëmbajtë dhe pastruar objekte të administratës komunale, shëndetësore dhe arsimore. Në këtë projekt janë paraparë hapësira të brendshme dhe të jashtme të mirëmbahen dhe pastrohen. Janë mirëmbajtë gjithsej 71489 m², ku hapësira të brendshme janë 15873 m² dhe hapësira të jashtme (oborret e objekteve) janë 55616 m². Në këtë projekt janë të punësuar 30 punëtor nga Komuna e Vitisë.

Me kontratën e lidhur në mes të komunës dhe kompanisë. AROMA PLUS shpk & KRASNIQI shpk Ntp BENI, nga Prishtina - me nr. Prokurimi VI657 -19-9074-2-2-1 nga dt. 01.04.2020-31.03.2021, për mirëmbajtjen e Objekteve Komunale dhe shëndetësore shuma është 159,063.60 € .

1.5 Mirëmbajtja e ndriçimit publik dhe Dekorimi i Qytetit

Në komunën tone kemi gjithsej llampa elektrike 10.882 cope, të cilat janë të vendosura në shtylla elektrike druri, betoni dhe shtylla metalike të zinguar. Kemi tri lloje të llampave elektrike: llampa me natrium-(zhivë)-100 cope, poca ekonomik 65 W- 4233 cope dhe të llojit LED 100Ë, 50V, 11Ë, 16Ë - gjithsej: 6549 cope. Në këtë raport nuk janë përfshirë dhe llogaritur trupat ndriçues që komuna këtë vit i ka bërë në ndriçimin publik, që do të thotë se kemi diku mbi 11.000 trupa ndriçues në territorin e komunës sonë të cilët mirëmbahen. Me kontratën e lidhur në mes të komunës dhe kompanisë dhe kompanisë N.N.P. "ATC COM" SH.P.K. me nr. Prokurimi VI657-20-6574-221 me datë 07.12.2020 – me vlefshmëri 06.12.2021 me vlerë prej 56.619.50 € pastaj kemi lidhur kontratën e re me Komunën së Vitisë dhe Kompanisë N.N.P. "ATC COM" SH.P.K. me nr. Prokurimi me numër VI657-21-6558-2-1-1 më dt. 23.11.2021 – 22.11.2022 shuma e kontratës: 80.845.00 € (tetëdhjetë e tetëqind e dyzet e pesë mijë euro)

1.6 Ujësjellësi dhe kanalizimi

Në komunën tonë për mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit, përgjegjëse është kompania regjionale "Hidromorava", njësi në Viti. Kompania në fjalë, bënë furnizimin me ujë të pijshëm dhe mirëmban kanalizimin, në qytetin e Vitisë, fshatit Drobesh, Ramnishte, Pozharan, Qifllak dhe Letnicë. Ndërsa, në lokalitet tjera ku rrjetet e ujësjellësve dhe rrjetet e kanalizimeve nuk mirëmbahen nga kompania regjionale "Hidromorava", njësi punuese në Viti, janë mirëmbajtur nga operatori ekonomik "Vizioni BD" nga Vitia, i kontraktuar nga Komuna e jone. Janë përcjell punët e kompanisë për mirëmbajtjen e ujësjellësve dhe kanalizimeve nga ana e drejtorisë dhe gjate kësaj periudhe raportuese janë bërë 85 intervenime në rregullime të kanalizimit dhe ujësjellësit, zhbllkime të kanalizimit, ndërrim të gypave, vendosje të pushtave, vendosje kapakëve nga betoni, vendosja e kapakëve nga metali etj. Gjatë vitit raportues për këto shërbime kemi shpenzuar shumën prej 22,397.500 Euro.

1.7 Mbeturinat

Eco-Higjiena si kompani publiko-private, njësi në Viti, bënë mbledhjen, transportimin e mbeturinave në deponin regjionale në Velekinc të Gjilanit dhe atë nga këto vendbanime të Komunës: Qyteti i Vitisë, Drobesh, Smirë, Terpezë, Pozharan, Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Ulët, Radivojcë, Fshati Ri, Budrik, Remnik, Ramjan, Beguncë, Kabash, Germovë, Sodovin e Jerlive, Sadovin e Qerkezeve, Verban, Ramnisht, Goshicë, Skifteraj, Terstenik, Podgorc, Stubëll e Epërme, Lubishte, Binçë, Devajë dhe Qifllak. Duhet përmendur faktin se donacioni i fituar nga Komuna e jone, nga Grandi i performances, nga GIZ-Gjerman dhe Ministria e

Planifikimit Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit, po ju kthehet qytetarëve, duke i furnizuar me kontejner familjar 120 L dhe kontejner plastike e te metalta me mase vëllimi prej 1.1 m³. Këta kontejner e qe janë gjithsej 2855 kontejner familjar dhe 126 kontejner 1.1 m³, janë shpërndarë nga ana e kompanisë klientëve të rinjë dhe të vjetër, ndërsa kontejnerët 1.1 m³ janë vendosur ne disa pika ne qytet dhe janë zëvendësuar të dëmtuarit neper institucione.

Deponitë ilegale

Ne fillim të vitit raportues janë evidentuar disa deponi ilegale nga disa zyrtar tonë dhe qytetarët. Gjate kësaj periudhe raportuese DSHPE-ja ka eliminuar gjithsej **3 deponi ilegale** të regjistruara dhe shumë te tjera, qe kohe pas kohe krijohen në vende te caktuara. Qëllimi ynë është që gjatë gjithë kohës të bëjmë parandalimin e krijimit të Deponive Ilegale.

TABELA E DEPONIVE QË JAN LARGUAR PËR VITIN 2021

Nr.	Vendi i deponive	Sasia	Të pastruara	Data e pastrimit	Komuna
1.	Pozharan	1	1	28.08.2021	Viti
2.	Gërqar	1	1	22.10.2021	Viti
3.	Rruga Viti - Pozharan	1	1	08.12.2021	Viti
	Totali	3	3		

Gjatë gjithë kohës mund të shfaqen deponi ilegale të tjera, e të cilat në të ardhmen duhet të evidentohen, regjistrohen dhe të largohen.

1.8. Punët me Skipin e Komunës

Për periudhën raportuese Janar- Dhjetor janë bërë gjithsej 112 intervenime me skipin e Komunës, nëpër lokalitete te ndryshme te Komunës sonë si: Hapja e kanaleve të ndryshme, largimin e borës nga rruga në disa rrugica të qytetit dhe në disa lokalitete rurale, largimin e mbeturinave interne, varrosjen e kafshëve te ngordhura, mbyllja e rrugëve malore me kërkesë të Drejtorisë së Bujqësisë, rregullimi i hapësirave publike dhe rregullimi i rrugëve nga gërryerjet erozive. Pra, me skipin e komunës janë kryer punë të ndryshme dhe atë në total 443 orë punë janë bërë për periudhën raportuese.

2. Sektori i emergjencave

Në sektorin e Emergjencave janë kryer këto punë:

Azhurimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike në rast fatkeqësish. (janar-Dhjetor); Bashkëpunimi me SHZSH. (janar-dhjetor); Punët e përditshme administrative. (janar-dhjetor); Angazhimi rreth zjarreve pyjore ne shkurt-gusht 2021.

Zjarret:

Zjarri në njësinë “ZHEGOVC I JUGUT” të cilat janë shfaqur duke filluar nga data 4. 08. 2021 dhe ka zgjatur për deri me 9. 08. 2021. Përcjellja e gjendjes në teren dhe këmbimi i informatave me Qendrën regjionale për te gjitha llojet e situatave. Intervenim konstant gjatë të reshurave të shiut te Kisha katolike, pastrimi i mbeturinave në prrockë dhe në pjesën jugore të qytetit, monitorimi i gjendjes gjatë gjithë kohës sa ka pas të reshura (tremujori i parë). Angazhimi në mbarëvajtjen e “Zonjës së madhe” në Letnicë-gusht 2021. Intervenim në disa Kompani private, shtëpi banimi nga të cilat është larguar uji me pompa (SHZSH-SMSH). Azhurimi i të dhënave dhe dërgimi në AME. Zjarrfikësja dhe shpëtimi: dalje të përgjithshme 680.

QENDRA OPERATIVE LOKALE ka kryer funksionin e vet nga shpallja e gjendjes pandemike, mars 2020, deri me sot, dhe nga ajo kohë deri tash jan lëshuar mbi 150 leje qarkullimi gjat orës policore.

2.1 Njësia profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim (NJPZSH) - VITI.

NJPZSH ne Viti, gjatë kësaj periudhe raportuese i ka kryer me përgjegjësi profesionale të gjitha punët dhe detyrat te cilat me ligje është e obliguar t i kryej. Edhe gjate kësaj periudhe te Pandemisë njësi ka punuar me kapacitete të plota. Me COVID-19 kanë qenë të prekur dy zjarrfiksa dhe dy tjerë kanë pasur kontakt, andaj edhe kanë munguar me arsye në punë. Gjatë vitit 2021, ka pasur një aksident rrugorë, ku janë lënduar dy zjarrfiksa. Kapacitete teknike, automjetet kanë qenë në gjendje të mesme për intervenime, Stafi i Zjarrfiksave për Vitin 2021 ka qenë 26 Zjarrfiksa, një Inspektor i parandalimit të Zjarrit dhe 7 zjarrfiksa punëtor sezonal ku kanë ndihmuar rreth fikjes se zjarreve dhe intervenimeve te tjera.

Dalje të Përgjithshme në Intervenime: **680**

Zjarre: **560**

Intervenime Teknike: **20**

Shërbime: **59**

Aksidente Rrugore: **15**

Dalje në Vërshime: **25**

Lajmërime të Rrejshëm: **1**

Prej tyre janë:

- Zjarre në Objekte ndërtimore-**38**,
- Zjarre në objekte ekonomike- **05**,
- Zjarre në pajisje elektrike-**15**
- Zjarre në sipërfaqe të hapura: Zjarre në male-**89**, Zjarre ne bari i thatë-**349**, Zjarre në mbeturina-**56**, gjithesej: **494**
- Zjarre ne automjete-**8**.

Do të thotë se vetëm numri i zjarreve ka qenë: **560**.

2.2. Mirëmbajtja e aparateve kundër zjarrit

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencia ka zhvilluar procedurën e prokurimit dhe ka kontratën, Shërbimet e mirëmbajtjes së pajisjeve kundër zjarrit dhe furnizim me aparate të reja për nevojat e NJPZSH dhe Administratës komunale me numër VI657-21-029-236 me vlefshmëri nga data 13.12.2021 e deri me datën 12.12.2022 e që në muajin dhjetor janë servisuar të gjithë aparatet, ndërsa servisimi i tyre behet për çdo 6 muaj.

2.3 Inspektori i preventives ndaj zjarrit

Inspektime te përgjithshme.....54

Inspektime ne sektorin privat.....42

Inspektime ne sektorin shoqëror12

Nr. i vërejtjeve 178

Nr. propozim masave.....178

Shikime ne vende ngjarje te zjarreve.....34

Raporte zjarri për Njësitin hetues ne Polici.....18

Kërkesa nga palët.....1

Vërtetime zjarri për palët e dëmtuara.....1

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Zyra e Drejtorit të DSHMS-së përbehet nga Drejtori, juristi dhe punëtori i administratës. Punët të cilat janë kryer nga stafi i drejtpërdrejtë i drejtorit janë paraqitur në tabelën si në vijim me të dhënat konkrete të punëve, si ndarja e subvencioneve për ndihmë momentale të cilat janë aprovuar nga komisioni në përbërje të tre anëtarëve pastaj edhe ato të cilat janë pranuar, të proceduara dhe të aprovuara, si dhe ato që janë refuzuar dhe janë nën pezullim. Drejtoria e e DSHMS-së gjatë periudhës gjashtëmujore është përballur edhe me pandeminë Covid-19. Gjatë kësaj kohe përveç detyrave normale të zyrës ka pasur qëllim edhe luftimin e pandemisë si dhe në organizimin me përballje me sfida të cilat janë paraqitur gjatë kësaj periudhe emergjente.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) me 11 njësitë në territorin e Komunës së Vitisë

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ka kryer shërbime që të jetë sa më afër qytetarëve dhe të jetë në shërbim të kërkesave të tyre, duke u munduar që të rregulloj sadopak mirëqenien e tyre si në aspektin shëndetësor ashtu edhe në atë psikosocial.

Komuna e Vitisë ka 46989 banorë.

QKMF në Viti ka filluar punën në vitin 1954. Në fillim kanë qenë 17 punëtorë, 4 mjekë, 10 infermierë dhe 3 punëtorë teknik.

Sot QKMF në Viti ka të punësuar 132 punëtorë, prej tyre 28 mjekë, 87 infermier dhe 17 punëtorë teknik dhe administrate.

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare bëhet ofrimi i shërbimeve mjekësore për qytetarë sipas

Raporti dhe Pasqyra totale e kërkesave në DSHMS – Janar Dhjetor 2021						
Lloji i kërkesës	Pranuar	Aprovuar	Refuzuar	Procedurë	Ceduar	Shuma
Kërkesa për ndihma momentale	262	149	113	0	0	21,350.00 €
Kërkesa për ndihme financiare për Covid-19 (Vdekjet)	70	66	4	0	0	32,340.00 €
Kërkesa-shkresa te ndryshme	33	32	1	0	0	
Gjithsej	365	247	118	0	0	

këtyre kategorive mjekësore:


- Në QKMF në qytetin e Vitisë punohet 24 orë. Të gjitha shërbimet mjekësore familjare, stomatologjike, pediatrike, interne, radiologjike dhe laboratorike kryhen vetëm gjatë ndërrimit të parë të orarit të punës.
- Qendra e emergjencës punon gjatë 24 orëve për çdo ditë të javës.


1. Shërbimet primare:

- Mjekësia Familjare
- Stomatologjia
- Vaksinimi
- Emergjenca
- Diagnostika (Laboratori dhe Shërbimi Radiologjik)

2. Shërbimet specialistike

- Pediatria
- Gjinekologjia
- Shërbimi i sëmundjeve të brendshme (Internisti)





Funksionimi i shërbimeve shëndetësore në komunën e Vitisë

QMF-të si dhe AMF-të të cilat kanë funksionuar gjatë kësaj periudhe në komunën e Vitisë janë:

- 1.QMF-Pozheran
- 2.QMF-Sllatinë e Epërme
- 3.QMF-Smirë
- 4.QMF- Sadovinë e Jerlive
- 5.AMF-Beguncë
- 6.AMF-Skifteraj
- 8.AMF-Stubëll
- 9.AMF-Tërpezë
- 10.AMF -Letnicë nga muaji prill (e mbyllur ne tetor, për shkak qe infermierja e ka lëshuar vendin e punës)
11. AMF - Remnik

Gjendja në terren

1. Në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Pozheran punohet 24 orë pa ndërprerë. Në kuadër të kësaj qendre ofrohen të gjitha shërbimet e mjekësisë familjare, si dhe shërbime stomatologjie, por edhe kryhen analiza të ndryshme laboratorike gjatë ndërrimit të parë, gjithashtu ka funksionuar hapësira e veçantë për trajtimin e pacientëve të prekur me COVID-19.
2. Qendra e Mjekësisë Familjare në Sllatinë të Epërme ofron shërbime infermierike dhe mjeku gjatë gjithë javës në orar të rregullt deri në muajin gusht. Prej muajit gusht ofrohen vetëm shërbime infermierike.
3. Në QMF-në në fshatin Smirë punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierike.
4. Në QMF-në në fshatin Sadovinë të Jerlive punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierie.
5. Në AMF-në e Skifterajt punohet dhe ofrohen shërbime çdo ditë punë nga ana e infermierëve përveç vikendit.
6. Në AMF-në e fshatit Beguncë ofrohen shërbime infermierike çdo ditë pune përveç vikendit.
7. Në fshatin Tërpezë shërbimet mjekësore ofrohen çdo ditë pune nga infermieret.
8. Në AMF-në në fshatin Stubëll e Epërme punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit.
9. Në AMF-në në Letnicë shërbimet shëndetësor nga infermierja kane filluar në muajin prill, pas një ndërprerje për shkak të situatës me covid dhe mungesës së stafit.
10. Në AMF-në në fshatin Remnik punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit.

Shërbimet e ofruara nga QKMF-ja –QMF-ja dhe AMF-të

Shërbimet të cilat u janë ofruar qytetarëve në QKMF, QMF dhe AMF-të për këtë vit janë dhënë 439729 shërbime.

Mjetet e grumbulluara nga participimi për shërbime shëndetësore janë **51718.8 €**.

Numri i Vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë gjatë këtij viti ka arrit në 924 vizita.

Numri i vizitave mjekësore gjatë këtij viti ka qene 150970 vizita mjekësore.

Analiza laboratorike 17042.

Shërbime te rëntgenit 2099.

Shërbime ne teren 8700.

Llojet e shërbimeve shëndetësore në QKMF, QMF dhe AMF-të

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE "NËNE TEREZE"-VITI
RAPORT DYMBDHJET MUJOR

JANAR -DHJETOR 2021												
Repartet	Vizita	Vizita s	Vizita C	Therrie	Infuzion	Transfe	Transf Di	Lidhëje	Inhalime	Këshilla	Ekg	Nr.
Emergjencia	48476	629	186	29976	14674	5251		1522			858	
Mjekësia Familjare 1	17333			5935		2889						
Mjekësia Familjare 2	7845					1344						
Mjekësia Familjare 3	6748					1116						
Stomatologjia	2180											
RTG	2099											
Dhoma e Inf Covid			5860		4528							
Dhoma e Infuzioneve					2387							
Laboratori	12013											
Pediatri	3558											1E
Interno	655					39	101			286		
Ekipa e terenit Caritas		1049		460	280			85			296	
Ekipa e terenit QKMF		1177		176	831			52				
Kontrolla Gjinekologjike	1786			314		112						
Vizita per nene dhe femijen		924								496		
Shërbimi i Vaksinimit	3644			7497								
Inhalime ne QKMF Viti												
Lidhëtorja								484				
TOTALI	106337	3779	6046	44358	22700	10751	101	3882	484	782	1154	1E
NUMRI I VIZITAVE NE AMBULLANTAT E QENDRES KRYESORE TË MJEKËSISË PRIMARE												
Amb. Smirë				56	1			53	8	492		
Amb. Sadovin	45			161	1			96	10	34		
Amb. Sllatin	383			1021	331			176		44		
Amb. Pozheran Covid			1927	424	1426							
Amb. Pozheran	38770			15848	9871	5745		1551	41		287	
Laboratori Pozheran	5029											4E
Stomatologjia pozheran	599											
Amb. Terpez				163	65			104	42	218		
Amb. Gjylekar				134	80			65		202		
Amb. Beguncë				74	5			165	12	163		
Amb. Remink	83			34	13			10		28		
Amb. Letnic	158			214				51		74		
Amb. Stubell	370	829		330				98		119		
TOTALI	45196	1070	1927	18459	11793	5745		2369	113	1374	287	4E
	105905	3779	6046	44358	22700	10751	101	3882	484	782	1154	1E
	45065	1070	1927	18459	11793	5745		2369	113	1374	287	4E
GJITHSEJ TOTALI	150970	4849	7973	62817	34493	16496	101	6251	597	2156	1441	2E

GJITHSEJ SHËRBIME 439729

Raporte Statestikore

E-mail: Zekirja.mustafa@gmail.com

Kordinatori I S.I.SH
Zekirja Mustafa

Drejtori QKMF
Dr. Vjollca Kadolli Ha

Rastet e testuara për COVID19 në Komunën e Vitisë prej 01.01.2021	
Komuna e Vitisë	
Testime në komunën e Vitisë	10293
Raste Pozitive	2825
Raste negative	7467
Raste aktive	4
Te vdekur	102

PARTICIPIMI vjetor ne QKMF

	Muaji	Shuma
1	janar	2,115.70 €
2	shkurt	3,810.90 €
3	mars	3,978.50 €
4	prill	3,176.50 €
5	maj	2,889.10 €
6	qershor	4452.60 €
7	korrik	4386.2
8	gusht	4973.3
9	shtator	4555
10	tetor	3334
11	nëntor	4080.1
12	dhjetor	9966.9
	Gjithsej	51718.8 €

Investimet ne QKMF,QMF dhe AMF për vitin 2021:

1. Përrurimi Ambulantes e fshatit Terpezë;
2. Vendosja e rrethojave ne QMF në Sllatine e Epërme;
3. Rregullimi I nxehjes me rrymë në QMF Sadovinë e Jerlive, Sllatinë e Epërme, Smirë edhe në AMF Beguncë dhe Remnik.
4. Janë blerë pajisje mjekësore për mjek te ekipit të urgjencës në QKMF 5 dhe 5 tjera për ekipet e urgjencës në QMF Pozheran, gjithashtu janë blerë pajisje për stomatologji dhe gjinekologji. Këto pajisje përfshinë 10 çanta për terren, stetoskopa me manzhetë, otoskopa, ambu balona, qafore, termometra, aparate te glikemise, peshore me metër, sete për kirurgji të vogël, sete për gjinekologji, sete për stomatologji etj.
5. Furnizimi me pajisje mjekësore për shërbimin e urgjencës, stomatologjinë, gjinekologji, QMF-

Pozheran, AMF-Terpezë, Sllatinë, Remnik dhe Smirë.

6.Furnizimi me 4 aparate oksigjen koncentrator

7.Furnizimi me 2 aspirator per nxjerrjen e trupave te huaj nga organizmi

Donacionet

1. me 03.02.2021 katër dezinfektues me sensor, te vendosur ne Pozheran, Sllatine e Epërme, Sadovinë e Jerlive dhe Smirë nga UNICEF-i.
2. 12 SHKURT, QMF ne Pozheran furnizohet me Autoambulancë nga Ministria e Shëndetësisë.
3. 16 shkurt, nje qytetar dhuroi 6 inhalatore.
4. 12 maj Ministria e Shëndetësisë furnizoi QKMF me dy aparate oksigjeformuese.
5. 28 maj, Ambasada Amerikane ka dhuruar 1500 teste rapide dhe një aparat laboratorik për këto.
6. Me 17.06.2021 Misioni I Kombeve te bashkuara dhuroi 5000 maska për QKMF ne Viti
7. 24 qershor UNICEF ka dhuruar 30 pako higjienike ne kuadër të programit për vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë.
8. Me 22.07.2021 UNICEF-i ka dhuruar pako higjienike për QKMF-ne ne Viti.
9. Me 28.07.2021 FSK ka dhuruar 12000 maska mbrojtëse për qendrën e vaksinimit ne Viti.
10. Me date 01.09.2021 FSK ka dhuruar 8000 maska për personelin shëndetësorë te QKMF-se ne Viti.
11. Me date 16.09.2021 Shoqata humanitare „Nene Tereza“ ka dhuruar 80 maska për personel shëndetësorë.
12. Me 16.09.2021 Shoqata ekonomiko-kulturore „Qëndresa Kosovare“ me përkrahje nga Kuvajti ka dhuruar një Autoambulance për shërbimet e terrenit.
13. Me 27.10.2021 Shoqata ekonomiko-kulturore „Qëndresa Kosovare“ me përkrahje nga Kuvajti, ka dhuruar një Ekg dhe një optotip.

III Qendra për Punë Sociale

Në QPS-Viti, gjatë gjithë vitit, nga data 01. 01. - 31. 12. 2021, punët kanë rrjedhë në përputhshmëri me planifikimin dhe rrethanat e shkaktuara nga pandemia Covid 19, janë përmbushur dhe detyrat shtesë, në kuadër të ofrimit të shërbimeve për kategoritë e rrezikuara, që përfshihen në domenin e punës sociale, siç janë shpërndarja e kuponav, futja e të dhënave në bazën e të dhënave për 50 familjeve për sigurim shëndetësor nga dy kategoritë, pilot projekt, në përputhje me kriteret e përcaktuar nga vet UNDP si donator, përzgjedhur nga komisioni i QPS-së, për 147

familje janë shpërndarë kupona. Këtyre familjeve ju janë dhuru kupona për 6 muaj në vlerë nga 60 e 70 euro në muaj, dedikuar vetëm për artikuj ushqimor, 25 familje janë furnizu me dru për ngrohje sasia 2,30 metra, 15 familjeve u janë paguar shpenzimet e ujit nga UNDP. Numri i punëtorëve të angazhuar në QPS gjatë kësaj kohe është 9 punëtor aktiv, Drejtori QPS-së Udhëheqësi Shërbimit Social dhe 3 punëtor të shërbimit, Udhëheqësi i Shërbimit të asistencës dhe 1 punëtor të shërbimit, 1 punëtor i administratës dhe financave. Gjatë këtij 9 muaj kemi pas kalimin e punëtorit të asistencës Sylë Salihu nga shërbimi i asistencës në shërbimin social, përmes konkursit të brendshëm. Kishte konkurs edhe për plotësimin e vendit të punës në shërbimin e asistencës, ku kemi vendin e zbrazët që 2 vite edhe për në vendin e mbetur i zbrazët, pas kalimit të Sylës në shërbimin social por nuk ka konkurruar askush. Mbet obligim I Zyrës së Personelit që të shpall konkurs të jashtëm për plotësimin e këtyre vendeve. Po ashtu gjatë kësaj kohe me Kontratë në afat 6+6 është angazhu dhe një puntore praktikante, Vjosa Lutfiu përmes projektit të përbashkët të atëherë MPMS dhe Universitetit "Hasan Prishtina" Prishtinë. Po ashtu me kontratë mbi veprën për 6 muaj është punsu punëtori Ilir Sejdiu, të cilin e kemi angazhuar në shërbimin e asistencës, duhet theksu se gjatë kësaj periudhe është punuar me staf dhe orar të reduktuar, në përputhje me masat e aplikuara nga MSHK. Ju njoftojmë se për vitin 2022 do mbetet edhe një vend pune i zbrazët, shef i shërbimit social, punëtori i tanishëm pensionohet në muajin e prill.

SHËRBIMIT SOCIAL

<i>Kategoritë e rasteve</i>	<i>Raste të reja</i>	<i>Përseritja</i>	<i>Te bartura nga vitet tjera</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>Vendosja në institucione</i>	<i>Vërejtje</i>
<i>Raporte të çrregulluara bashkë - Besim I fëmijëve</i>	20	0	5	25		
<i>Te mitur në konflikt me Ligjin</i>	48	11	48	107		
<i>Dhuna në familje</i>	47	0	5	52		
<i>Te mitur me sjellje asociale</i>	25	0	5	30		
<i>Fëmijët e keqtrajtuar fizikisht</i>	12	0	7	19		
<i>Kujdestari e fëmijëve</i>	5	0	26	31		
<i>Fëmijët në strehim, familjar të të afërmit</i>	0	0	8	8		<i>Per secilin rregullta p. 60 € shtesa</i>
<i>Fëmijët e vendosur në famil.strehues</i>	4	0	0	4		<i>3 fëmijë pa vjetor 6.60</i>
<i>Adoptimi I fëmijëve</i>	2	0	4	6		
<i>Kontaktimet prind-fëmijë</i>	3	0	10	13		
<i>Keqtrajtimet-ngacimet sex.te fëmijë.</i>	3	0	0	3		
<i>Te moshuar pa përkujdesje familjare</i>	2	0	3	5	3-SHPMP F	

<i>Te rritur me nevoja te veçanta</i>	0	0	5	5	<i>Ne Shtime 2 ne Ferizaj 2 dhe ne Kamenice 1</i>	
<i>Fëmijët me nevoja te veçanta</i>	16	0	43	59		<i>Për se cilin rregullta p 60 € shtesë</i>
<i>Ftesa gjyqësore për te mitur</i>	29	0	0	29		
<i>Ftesa gjyqësore për te rritur</i>	26	0	0	26		
<i>Lypës te rrugës</i>	0	0	0	0		
<i>Masat e shqiptuara për te mitur; M.SH.P</i>	7	0	0	7		
<i>M.O.K.</i>	2	0	0	2		
<i>Qortim</i>	15	0	0	15		
<i>Burg</i>	0	0	0	0		
<i>Vërtetime për nënshtetësi</i>	74	0	0	74		
<i>Vërtetime për zotësi veprimi-Arme</i>	286	0	0	286		
<i>Vërtetime për zotësi veprimi-Pune</i>	31	0	0	31		
<i>Pune te rend atë fëmijëve</i>	0	0	0	0		
<i>Ankesa koms.mj.shk.II</i>	0	0	0	0		
<i>Fëmijët e vendosur ne institucionet mbrojtëse</i>	0	0	1	1		
<i>Vendosja stre-dhunë familje</i>	5	0	0	5		
<i>Regjistr.i mëvonshëm I fëmijëve</i>	3	0	0	3		
<i>Përdorues te narkotikeve</i>	2	0	0	2		
<i>Martesa e parakohshme</i>	2	0	0	2		
<i>Urdhër mbrojtje për viktimat e dhunës ne familje</i>	6	0	0	6		
<i>Shërim i detyrueshëm psikiatrik</i>	1	0	0	1		
<i>Kërcenim</i>	2	0	0	2		
<i>Raste tjera ne nevoje për shërbime</i>	94	0	0	94		
<i>Fëmijë i braktisur i porsalindur</i>	1		0	1		
<i>Trafikim</i>	3			3		
<i>Lindje Jashtëmartesore</i>	1			1		
<i>Të rritur me nevoja të veçanta</i>	2			2		
<i>Gjithsej</i>	779	11	175	965		

SHËRBIMI I ASISTENCËS

<i>Pasqyra e pagesave nga shërbime i asistencës gjatë këtij viti</i>			
<i>Nr.</i>	<i>Muaji</i>	<i>Numri familjeve</i>	<i>Pagesa mujore</i>
1.	Janar	501	108042.50 €
2.	Shkurt	508	109662.50 €
3.	Mars	506	109250.00 €
4.	Prill	482	66369.00 €
5.	Maj	486	67162.00 €
6.	Qershor	486	67112.00€
7	Korrik	487	66614.25€
8	Gusht	480	63908.00€
9	Shtator	485	66877.00€
10	Tetor	479	65578.50€
11	Nëntori	476	125115.75€
12	Dhjetor	476	124528.25
		447 familje mesatarja mujore	1 040 217.50 € në total

Gjitha rastet e shqyrtuara për Asistencë Sociale

<i>Rastet e shqyrtuara</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>Aprovuara</i>	<i>Refuzuara</i>
<i>Aplikim për herën e parë</i>	41	33	8
<i>Riaplikim</i>	600	569	31
<i>Gjithsej</i>	641	602	39

Lëndët e shqyrtuar nga komisioni mjekësor

<i>Të përgatitura</i>	<i>Të aprovuara</i>	<i>Të refuzuara në shqyrtim</i>
114	87	14 13

Lëndët e shqyrtuara simbas ankesës

<i>Të trajtuara</i>	<i>Aprovuara</i>	<i>Refuzuara</i>	<i>Gjithsej</i>
<i>Në shkallë të parë</i>	0	2	2
<i>Në shkallë të dytë</i>	2	6	8
<i>Në Gjykatë</i>	0	2 në shqyrtim	2
<i>Gjithsej</i>	3	10	13 në shqyrtim

Kërkesa për subvencione nga DPSF-DSAS

<i>Gjithsej</i>	<i>Të aprovuara</i>	<i>Të refuzuara</i>
9	2	9

Vërtetime të lëshuar brenda 5 muajve

<i>Me pages</i>	<i>Papages</i>	<i>Gjithsej</i>
238	13	251

Familje të zbuluara nga ATK

<i>Gjithsej</i>	
<i>Kanë kthyer mjetet</i>	19
<i>Në procesim</i>	10
	9

Vërtetime për student

<i>Gjithsej</i>	0
-----------------	---

Propozim për autorizim për tërheqjen e mjeteve

<i>Gjithsej</i>	3
-----------------	---

RAPORTI FINANCAR

Të hyrat vetanake financiare nga taksat komunale në QPS:

<i>Gjithsej</i>	417	199	218	0	0
<i>Të inkasuara</i>	<i>Të dorëzuara</i>			<i>Gjithsej</i>	
4.288,00 €	4.288,00 €			4.288,00 €	
<i>Gjithsej</i>					

Sa i përket shpenzimeve në shërbime të mallra, mirëmbajtja, rrymë, komunal nuk kemi evidencë, gjithat shkojnë përmes financierit të angazhuar në QKMF "Nëna Terez".
Me datën 27.10.2021 International Charity Organization ka bërë shpërndarjen e 100 pakove me mish për 200 familje Vitias ne nevojë.

Drejtoria për Arsim

Zhvillimi i procesit mësimor në Komunën e Vitisë zhvillohet që nga çerdhet, parashkollorët, mësimi i ulët i mesëm dhe ai i lartë mesëm, si dhe ai i mesëm profesional. Fillimi i procesit mësimor për periudhën e dytë në vitin shkollor 2020/2021, sipas vendimit të MASHT-it nr.01/B-

141 të datës 02.12.2020, ka filluar me datë 18.01.2021. Mësimi është zhvilluar sipas rekomandimeve të dhëna nga ana e IKPSH-së dhe MASHT-it me numër të kufizuar të nxënësve për klasë, dhe me orar të shkurtuar, gjë e cila ka qenë sfidë që të zhvillohet normalisht procesi edukativo-mësimor në disa shkolla, për shkak të hapësirës infrastrukturore, por gjithsesi mësimi është zhvilluar sipas skenarit A me prezencë të nxënësve në shkollë. Ne kemi filluar me kohë me planin e veprimit për aktivizim të shkollave sa i përket fillimit të mësimi online përmes platformave të ndryshme, sidomos atyre të propozuara nga ana e MASHT-it. Ndërsa fillimi i vitit të ri shkollor 2021-2022 ka filluar me prezencë të plotë fizike në klasë, pa reduktim të nxënësve por me kapacitet të plotë, gjithmonë me respektim të masave anti-covid të dala nga IKSHPK -ja dhe task forcave të shkollave. Gjatë kësaj periudhe janë përfshirë edhe:

- Ligjërata me nxënës, përcaktimi i orarit mësimor shkollor, raportimet ,etj. Ligjërata që në fokus kanë patur temat për menaxhimin e kohës në izolim, menaxhimin e ankthit, depresionit, stresit etj, nga ana e psikologëve shkollorë.
- Seanca me nxënës me nevoja të veçanta dhe me prindër për shqyrtime dhe ankesa për organizim më të mirë të mësimi.
- Zhvillimi i takimeve online dhe me prezence fizike, me MASHT-in.
- Trajnime me organizata të ndryshme.
- Mbajtja e kontakteve ne mes të DKA-së dhe MASHT-it.
- Raportimet dhe takimet e rregullta me drejtorët e shkollave dhe DKA-në.
- Raportimet e rregullta ndërmjet DKA-MASHT, dhe inspektoratit arsimor.
- Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore kemi pas edhe përballje me pandeminë Covid 19, dhe ne si DKA kemi marrë masa përkatëse me task forcat e shkollave që të zbatohen kriteret për mbrojtje sipas udhëzuesit të IKSHPK së, dhe manualit për zhvillimin e procesit mësimor.
- Bashkëpunimi nuk ka munguar edhe me qendrën e mjekësisë familjare në Viti në lidhje me shkëmbimin e informacioneve që kishin të bëjnë me stafin arsimor dhe nxënësit e infektuar, në mënyrë që të merren masa adekuate të izolimit dhe instruksioneve të tjera sipas nevojës. Të gjitha shkollat kanë qenë të furnizuara me material dezinfektues dhe pamflete udhëzuese. Gjatë kësaj periudhe kemi pasur të infektuar gjithsej 26 mësimdhënës dhe 16 nxënës në total.

1. Mbarëvajtja e mësimi në periudhën e dytë dhe të tretë

- Periudha e dytë e vitit shkollor ka mbaruar me datë 02.02.2021 dhe periudha tretë ka filluar me 12.04.2021, ku mësimi ka filluar sipas dy skenarëve në nivel vendi; klasat parafillore deri në klasën e V-të, zhvillojnë mësimet sipas skenari A, me prani fizike, ndërsa klasa e VI-XII zhvillohet sipas skenarit C, pra mësim online, që gjatë kësaj periudhe zgjatur vetëm një javë, pra më 19.04.2021, ka filluar mësimi sipas skenarit A, me prezence fizike për të gjithë.
- Periudha e III të ka filluar me datë 12.04.2021 sipas vendimit të MASHT-it për ndryshimin e kalendarit të vitit shkollor 2020/21 në arsimin parauniversitar, me nr.01/B/02 të datës 31.03.2021.

- Ditët e humbura të mësimi në periudhën e I dhe të II të sipas vendimit të lartpërmendur do të zëvendësohen me ditë mësimi: 5 ditë mësimi në fund të periudhës së tretë, ndërsa dy ditë të tjera u takon komunave të përcaktojnë ditët e shtuna për mbajtjen e mësimi zëvendësues.
- Janë kontrolluar të gjitha shkollat në aspektin profesional pedagogjik si dhe i gjithë dokumentacioni i nevojshëm.
- DKA-ja ka bërë parapërgatitjet për Testin e Arritshmërisë për klasat e IX-ta dhe për Testin e Maturës Shtetërore për klasat e XII-ta.
- Kemi dërguar në MASHT, shënimet statistikore përmes Sistemit të SMIA-së, për numrin e nxënësve sipas paraleleve në secilën shkollë, numri i personelit arsimor etj.
- DKA-ja, ka shtuar aktivitetet për ngritjen e interesimit të nxënësve për testet e Arritshmërisë dhe Maturës Shtetërore, duke i njoftuar nxënësit për mënyrën e plotësimit të testit për fushat e dijes në cilat ata do të testohen etj.
- Po ashtu arsimtarët e fushave të ndryshme, me qëllim të ngritjes së tyre profesionale kanë marrë pjesë në trajnime ,seminare, debate etj.
- Janë mbajtur debate, konsulta për tema të ndryshme rreth dukurive negative të nxënësve nëpër shkolla.
- Në mënyrë të rregullt kemi përcjellë procesin edukativo-arsimor.
- Është bërë dezinfektimi i të gjitha objekteve shkollore.
- Gjatë kësaj periudhe është kryer edhe vaksinimi i maturantëve .
- Organizimi i Testit të Arritshmërisë për klasat e IX-ta dhe Testit Kombëtar për klasat e XII, është organizuar dhe mbajtur sipas vendimit të MASHT-it, konform situatës pandemike si në vijim:
 - ✓ Testi i Arritshmërisë më datë 28.05.2021 , me pjesëmarrje të 592 nxënësve, dhe e mbajtur në katër qendra shkollore , 3 në viti dhe 1 në fshatin Pozheran. Arritshmëria për 100 pikë ka tejkaluar kuotën e 65 pikëve.
 - ✓ Testi Kombëtar i Maturës është mbajtur më 26 qershor 2021 , me pjesëmarrje të 482 prej 509 maturantëve dhe kalueshmëria ishte 65.35%. Testin e kaluan 315 nxënës , dështuan 167.

2. Përfundimi i vitit shkollor

- Komuna e Vitisë me gjithsejtë 17 shkolla fillore të mesme të ulëta si dhe 17 paralele të ndara, 3 shkolla të mesme të larta me gjithsejtë 7656 nxënës dhe dy çerdhe për fëmijë, (njëra private), ka gjithsejtë 150 fëmij (shih tabelën nr. 1 dhe 2).
- Viti shkollor 2020/21 apo gjysmëvjetori dytë, periudha e tretë është përfunduar në të gjitha shkollat me data të parapara nga kalendari i rivlerësuar i MASHT-i sipas vendimit nr.01B/51 me 15.06 2021 për ndryshimin e kalendarit të vitit shkollor 2020/21 në arsimin parauniversitar
 - ✓ Klasat 0, 1- 8, përfundojnë mësimin me 2 korrik,2021
 - ✓ Klasat IX-X dhe XI përfunduan mësimin me 21 qershor, 2021
 - ✓ Klasa e XII përfunduan më 02.06.2021

- ✓ Mësimi plotësues sipas vendimit të MASHT-it ka filluar me datë 05.05.2021 në të gjitha shkollat e komunës së Vitisë aty ku është paraqitur nevoja për mësim shtesë në mësimnxënie.
- ✓ Afati i dytë i gushtit për testin e maturës është mbajtur me pjesëmarrje të 107 nxënësve
- ✓ Testit të maturës është dashur t'i nënshtrohen 484 nxënës në të dy afatet, ndërsa e kanë kaluar 389 nxënës, ose kalueshmëria e përgjithshme është 80.4 %, ndërsa 95 nxënës nuk i kanë arritur pikët e mjaftueshme, shprehur në përqindje 19.6%.

Shkolla	vendi	Parashkollor	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Klasa 4	Klasa 5	Klasa 6	Klasa 7	Klasa 8	Klasa 9	Gjithsej
		Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej
Hysen Terpeza	Terpezë	19	21	15	15	20	20	21	26	21	24	202
Kenan Halimi	Gjylekarë	16	35	27	18	21	24	18	29	23	35	246
Ahmet Hajdari	Beguncë	7	15	6	13	14	14	12	14	18	22	135
Dëshmorët e Lubishtës	Lubisht	20	24	16	14	16	23	22	18	20	12	185
Dëshmorët e Lubishtës 1	Buzovik	0	5	6	9	9	7	6	14	8	4	68
Dëshmorët e Lubishtës 2	Podgorc	0	3	2	7	2	0	0	0	0	0	14
Njazi Rexhepi	Sllatinë e epë	30	20	15	21	20	23	32	24	29	39	253
Njazi Rexhepi 1		0	14	15	18	10	13	9	10	13	11	113
Njazi Rexhepi 2		19	13	10	17	9	17	16	12	16	18	147
Njazi Rexhepi 3		10	9	16	14	14	13	0	0	0	0	76
Njazi Rexhepi 4		10	4	12	9	8	16	23	10	19	19	130
Ndre Mjeda	Kabash	0	24	27	24	16	33	32	47	21	42	266
Ndre Mjeda 1	Debuldeh	0	0	1	2	2	2	1	0	3	4	15
Ndre Mjeda 2	Binq	0	2	3	3	0	0	0	0	0	0	8
Dëshmorët e 5 Prillit	Smirë	36	38	31	37	43	26	44	43	36	52	385
Don Mikel Tarabulluzi	Stubbëll	7	6	10	8	6	14	13	9	15	8	96
Don Mikel Tarabulluzi 1	Letnicë	0	5	0	5	3	0	0	0	0	0	13
Safet Rexhepi	Zhiti	10	12	4	11	10	0	4	8	6	7	72
Safet Rexhepi 1	Ballanc	0	0	11	5	11	9	6	5	9	11	67
Skender Emerllahu	Ramjan	10	17	11	12	19	10	25	14	20	24	162
Skender Emerllahu 1	Novosellë	10	14	10	5	0	22	0	0	0	0	61
Bafti Haxhiu	Viti	45	74	49	69	70	90	66	70	80	72	685
Bafti Haxhiu 1	Ramnishë	12	22	13	18	23	20	11	14	8	24	165
Nazmi Pajaziti	Radivojc	20	23	18	26	17	15	21	21	16	25	202
Nazmi Pajaziti 1	Budrikë	10	12	11	6	7	10	10	8	10	6	90
Nazmi Pajaziti 2	Devajë	0	0	4	2	2	2	0	0	0	0	10
Hasan Alia	Remnik	22	16	25	22	10	20	10	22	16	12	175
Mirali Sejdiu	Goshic	10	8	8	13	11	10	9	13	13	16	111
Mirali Sejdiu 1	Gërmovë	10	10	5	16	16	13	6	9	8	10	103
Halil Alidema	Pozhoran	37	50	35	60	47	43	43	44	41	64	464
Dëshmorët e Vitis	Viti	33	59	56	48	48	48	101	103	73	79	648
Dëshmorët e Vitis 1	Drobesh	18	27	30	20	32	29	0	0	0	0	156
28 Nëntori	Yërbani	22	22	26	27	28	25	28	14	32	33	257
28 Nëntori 1	Sodovinë e je	10	10	20	17	16	7	22	18	16	25	161
Gjithsej		453	614	548	611	580	617	611	619	590	698	5941

Tabela 1: Numri i nxënësve në SHMU-të në komunën e Vitisë sipas shkollave.

SHKOLLA	Drejtimi	Vendi	Numri i nxënësve			Gjithsej
			Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	
Kuvendi i Lezhës	Gjimnazi	Viti	315	309	326	950
“Jonuz Zejnullahu”	Profesionale	Viti	165	188	185	538
Kongresi i Manastirit	Mikse (Gjimnaz, Profesionale)	Pozhoran	75	61	91	227
			555	558	602	1715

Tabela 2: Numri i nxënësve në SHML-të e komunës së Vitisë sipas shkollave.

3. Fillimi i vitit të ri shkollor 2021-2022

Për shkak të gjendjes së rënduar më pandemi, përhapjes së variantit Delta -Covid 19, mësimi nuk ka filluar sipas kalendarit shkollorë por filloi me vonesë sipas udhëzimeve të IKSHPK së dhe MASHT it, me datë 27.09.2021, me prezencë fizike të nxënësve në klasat e tyre, pa ndarje dhe kufizime në nxënës sipas skenarit A dhe me orar të plotë sipas legjislacionit në fuqi, gjithnjë duke respektuar masat anti covid dhe sugjerimet e task-forcave nëpër shkolla. Fillimi i vitit të ri shkollor në shkolla të mesme të ulëta filloi me 5788 nxënës dhe në shkolla të mesme të larta, numri i nxënësve është 1604 nxënës, ndërsa në çerdhe 150 fëmijë. Gjithsej numri i nxënësve në shkollat dhe çerdhet në komunën e Vitisë është 7392 nxënës. Ndryshimi në nxënës ndërmjet dy viteve shkollorë është 264 nxënës më pak. Në shkollat e mesme të ulëta kemi 111 nxënës më pak, përderisa në shkollat e mesme të ulëta kemi 153 nxënës më pak në krahasim me vitin paraprak shkollor.

			Para	KL. I	KL. II	KL. III	KL. IV	KL. V	KL. VI	KL. VII	KL. VIII	KL. IX	KL. X	Nxënës
	Shkolla	vendi	Nr. Nx	Nr. Nx	Nr. Nx	Nr. Nx	Nr. Nx	Nr. Nx	Nr. Nx	Nr. Nx	Nr. Nx	Nr. Nx	Nr. Nx	Gjithsej
1	Dëshmorët e Vitis	Viti	45	50	59	56	48	48	48	75	75	52		556
2	Dëshmorët e Vitis	Drobesh	33	20	27	30	20	32	29	27	28	25		271
3	Bafti Haxhiu	Viti	59	64	78	49	69	69	80	63	69	81		681
4	Bafti Haxhiu	Ramnishtë	13	10	23	15	21	24	22	10	14	8		160
5	Njazi Rexhepi	Sllatinë e epërme	16	12	20	14	20	19	35	32	24	28		220
6	Njazi Rexhepi	Sllatine te lagjeja	17	14	15	15	18	10	13	9	9	13		133
7	Njazi Rexhepi	Sllatinë e poshtme	10	18	13	10	17	9	16	15	11	16		135
8	Njazi Rexhepi	Sodovinë e qerkezve	7	7	9	15	14	14	0	0	0	0		66
9	Njazi Rexhepi	Trestenik	7	11	4	12	9	7	16	20	8	18		112
10	Halil Alidema	Pozhoran	46	44	49	35	61	47	48	41	44	49		464
11	28 Nëntori	Vërban	22	22	22	26	25	28	25	26	28	31		255
12	28 Nëntori	Sodovinë e jerlive	20	10	11	19	16	16	6	21	17	16		152
13	Dëshmorët e 5 Prillit	Smirë	18	33	36	31	37	42	25	44	42	36		344
14	Ndre Mjeda	Kabash	14	20	22	27	25	16	32	41	45	21		263
15	Ndre Mjeda	Debuldeh	0	1	0	0	0	2	1	0	0	2		6
16	Ndre Mjeda	Binq	0	1	2	4	3	0	0	0	0	0		10
17	Kenan Halimi	Gjylekarë	20	14	34	27	19	21	24	18	29	23		229
18	Nazmi Pajaziti	Radivojc	16	15	26	18	27	17	16	21	21	16		193
19	Nazmi Pajaziti	Budrikë	8	10	11	11	6	7	10	9	8	9		89
20	Nazmi Pajaziti	Devajë	0	5		4	2	2						13
21	Dëshmorët e Lubishtës	Lubisht	20	25	23	16	14	17	23	22	18	20		198
22	Dëshmorët e Lubishtës	Buzovik	0	8	5	6	11	9	7	6	14	7		73
23	Dëshmorët e Lubishtës	Podgorc	0	4	2	2	5	3	0	0	0	0		16
24	Hysen Terpeza	Terpezë	20	21	18	15	27	20	20	21	25	21		208
25	Hasan Alia	Remnik	17	22	15	22	21	10	14	10	20	14		165
26	Skender Emerllahu	Ramjan	8	9	17	10	12	17	20	24	14	20		151
27	Skender Emerllahu	Novosellë	9	14	14	10	5	10	0	0	0	0		62
28	Mirali Sejdiu	Goshic	10	10	8	8	13	10	10	9	12	13		103
29	Mirali Sejdiu	Gërmovë	9	9	7	5	16	16	13	6	9	8		98
30	Ahmet Hajdari	Beguncë	12	6	15	6	13	14	15	11	14	18		124
31	Safet Rexhepi	Zhiti	10	2	12	4	11	10	0	3	8	6		66
32	Safet Rexhepi	Ballanc	0	10	0	11	5	11	9	6	5	9		66
33	Don Mikel Tarabulluzi	Stubbëll	6	6	6	9	8	9	13	12	9	15		93
34	Don Mikel Tarabulluzi	Letnicë	0	5	5	0	3	0	0	0	0	0		13
	Gjithsej		492	532	608	542	621	586	590	602	620	595		5788

Tabela nr. 3: Tabela statistikore për shkolla të mesme të ulëta me numrin e nxënësve në klasa për vitin shkollor 2021/22

			KL. X	KL. X	KL. XI	KL. XI	KL. XII	KL. XII	Paralele	Nxënës
SHKOLLA	Drejtimi	Vendi	Nr. i Par.	Nr. Nxë.	Nr. i Par.	Nr. Nxë.	Nr. i Par.	Nr. Nxë.	Gjithsej	Gjithsej
Kuvendi i Lezhës	Gjimnazi	Viti	13	305	13	309	13	304	39	918
Jonuz Zejnullahu	Profesionale	Viti	13	158	13	145	14	168	40	471
Kongresi i Manastirit	Mikse (Gjimnaz,	Pozhoran	6	75	5	80	4	60	15	215
			32	538	31	534	31	532	94	1604

Tabela nr. 4: Shënime mbi numrin e nxënësve sipas klasave në SHML

4. Aktivitetet në shkolla të ndryshme gjatë periudhës janar-dhjetor 2021

	Lloji i aktivitetit	Shkolla	Vërejtje
1	Garë e shahut, e organizuar nga pedagogët e edukatës fizike në shkollat e komunës së Vitisë.	Pjesëmarrëse 8 shkolla të komunës së Vitisë.	Garë sportive në shah 30.1.20021
2	Garat regjionale të shahut, në Gjilan	Pjesëmarrës disa shkolla të Vitisë	08.02.2021
3	Garat Komunale në Basketboll-organizuar nga pedagogët e kulturës fizike -	10 shkolla pjesëmarrëse të komunës së Vitisë.	11.03.2021
4	Garat regjionale në Basketboll në Gjilan-Vendi i II-të	Shkolla fituese SHFMU "Halil Alidema" Pozheran	18.03.2021
5	Është organizuar "Dita e tokës" për pastrimin e ambientit e sidomos oborreve shkollore, nën patronatin Komunës së Vitisë	Pjesëmarrëse të gjitha shkollat.	22.04.2021
6	Garë në ping-pong në nivel komunal për nxënësit e SHFMU-ve dhe atyre të mesme.	11 shkolla pjesëmarrëse	11.02.2021.
7	Garë në Volejboll për SHFMU-të dhe ato të mesme.	12 shkolla pjesëmarrëse	03.05.2021
8	Gara në Futboll për Sh.F.M.U- të dhe ato të mesme	22 shkolla pjesëmarrëse	22.05.2021
9	Olimpiada Matematike Komunale	Shkollat fillore dhe të mesme	22.02.2021
10	Olimpiada Matematike e Kosovës OMK-2021-Prishtinë Shoqata e Matematikanëve të Kosovës	Pjesëmarrës 6 nxënësit fitues të garës komunale.	27.02.2021

11	Vendi i katërt për nivelin 1-5 në nivel republikan në garat e Robotikës KML. Prishtinë.	Shkolla fituese SHFMU "Njazi Rexhepi" Trestenik	27.05.2021
12	Dita ndërkombëtare e fëmijëve u shënua në forma të ndryshme nëpër shkolla.	Në tërë shkollat e komunës së Vitisë.	01.06.2021
13	Ligjëratë mbi dhunën në familje dhe ndaj fëmijëve në bashkëpunim me Policinë e Kosovës.	SHFMU "Halil Alidema" Pozheran	02.06.2021
14	Vendi i dytë në R.Kosovës, në garën e zhvilluar në mes të 40 ekipeve të shkollave të mesme, implementuar nga Ministria e Ekonomisë, në projektin „Krijimi i Qendrave Kreative", ku ekipi e nxënësve të shkollës tonë garoi me projektin „Qyteti i gjelbërt" në fushën e elektronikës.	Shkolla e Mesme Profesionale "Jonuz Zejnullahu" Viti	01.06.2021
15	"Festa e Abetares" në shtëpinë e Kulturës	SHFMU "Bafti Haxhiu" Viti	30.06.2021
16	Ligjëratë "Së bashku kundër Bulizmit" në bashkëpunim me Policinë dhe Psikologjen e DKA-së" në shkolla të Vitisë	SHFMU "Dëshmorët e 5 prillit" SHFMU "Mirali Sejdiu" SHFMU "Nazmi Pajaziti" SHFMU "Kenan Halimi"	08.11.2021 24.11.2021 18.11.2021 25.11.2021
17	Ligjëratë "Dita botërore kundër Hiv-Aids" organizuar nga QKMF-ja	SHML "Kongresi i Manastirit" Kuvendi i Lezhës" dhe SHMP "Jonuz Zejnullahu"	01.12.2021
18	Murale në hollët e shkollës me tematikë nga të gjitha lëndët-Mësimdhënësit e Artit me nxënës.	SHFMU "Dëshmorët e Vitisë"	01.12.2021
19	Hapja e kabinetit të Rrobaqepësisë për nxënës përmes buxhetit komunal.	SHMP "Jonuz Zejnullahu"	

5. Shërbimi psikologjik

- Është bërë evidentimi i rasteve (nxënësve), të cilët kanë nevojë për shërbime psikologjike.

- Vazhdim i psikoedukimit me nxënës, duke përfshirë fusha të ndryshme
- Administrimi i testeve psikologjike, (vlerësimi psiko-fizik për klasën e parë)
- Mbajtja e seancave psikoterapeutike. Nxënësit janë trajtuar me: Këshillim psikologjik, teknika biheviorale, psikoterapi pozitive, psikoterapi trupore, psikoterapi familjare ,etj.
- Punë e vazhdueshme tek klasa e bashkëngjitur me nxënësit me nevoja të veçanta.
- Takime me ekipen për parandalimin dhe braktisjen e shkollës.
- Takime me ekipen për vlerësim pedagogjik të nxënësve.
- Bashkëpunim me QPS-në.
- Vizita nëpër shkolla.
- Prezentim në takime dhe punëtori.
- Takime në MASHT.
- Certifikimi i mësimeve, të cilët kanë përfunduar trajnimin për kurrikulë në vitin shkollor 2020/21.
- Bashkëpunim rreth recensimit të librave shkollorë në bashkëpunim me MASHT-in.
- Administrimi i Testit të Maturës për maturantët.

6. Zyra ligjore e DKA-së në Viti (Sekretaria)

Në periudhën janar-qershor janë protokolluar 1304 lëndë të natyrave të ndryshme: Për këtë periudhë kohore prej datës 01.01.2021 deri më 31.12.2021 janë kryer këto punë dhe shërbime:

- -Konkurse-11
- -Vendime -101
- -Përgjigje në padi -108
- -Ankesa drejtuar DKA-së- 11
- -Ankesa për gjykatën e apelit -2
- -Kërkesa nga organet e tjera- 272
- -Përgjigje në kërkesa-436
- -Pëlqime-14
- -Njoftime të ndryshme -30
- -Vërtetime -33
- -Urdhëresa -2
- -Autorizime -75

7. Sektori i financave

- Brenda kësaj kohe kemi kryer obligimet nga viti 2020 në vlerë prej 4940€.
- Të gjitha shkollat janë furnizuar me kohë me material higjenik, material harxhues, material pune për zyra etj.

- Po ashtu në këtë sektor janë bërë edhe ndryshimet në regjistrat e pagave si: Futja e punëtorëve të rinj në listat e pagave , Largime, Pagesa Retroaktive, Ndryshime të tjera si, ndërrimet e llogarive bankare për punëtorët etj. e qe ne total janë 487.
- Furnizimi i shkollave me material mbrojtës anti covid.
- Furnizimi i shkollave me inventar ne shkollat si: SHFMU-të "Ndre Mjeda", "Dëshmoret e Vitisë", " Bafti Haxhiu", " Mirali Sejdiu", "Dëshmorët e Lubishtës" , "Ahmet Hjdari", "Nazmi Pajaziti" , "Hasan Alia", Qerdhja "Gëzimi Ynë" në Viti dhe paralelja e ndarë në Qifllak,etj.
- Kemi bërë përgatitjen dhe shpalljen e tenderit për furnizim me lëndë djegëse(dru) per vitin shkollor 2021/22.
- Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse, gjithsej 2950 m³.
- Kemi përgatitë dhe shpallë tenderët për furnizime me material higjienik, furnizim me perde dhe tepison, furnizimi me pajisje të imta, furnizimi me internet etj.
- Po ashtu në sektorin e financave është bërë edhe zotimi i mjeteve për komplet organizatën buxhetore ku janë zotuar 433 pagesa.
- Është përgatitur korniza afat-mesme buxhetore për vitet 2022-2024.
- Është përgatitur buxheti për sektorin e arsimit sipas programeve dhe shkollave ku totali i buxhetit përfshinë vlerën prej 6,015,806.00 €.
- Janë pranuar dhe shpërndarë listat e pagave dhe janë kompletuar me nënshkrime nga shkollat.
- Si edhe pune të tjera me kërkesë të drejtorit.

8. Donacionet

	Donacioni	Shkollat përfituese	Data
1	45 Ipad nga UNICEF-i, në bashkëpunim me MASHT-in	Në të gjitha shkollat për nxënësit me nevoja të veçanta	Janar 2021
2	15 kompjuterë nga Kompania KEDS.	SHFMU "Dëshmorët e Vitisë" paralelja në Drobesh	1 Qershor 2021
3	Donacion nga "Karitasi Zvicerian" me participim të komunës me 30%, në renovimin dhe mobilimin e klasave parashkollore në tri shkolla.	SHFMU "Hasan Alia" Remnik, "Dëshmorët e Vitisë: paralelja-Drobesh dhe "Nijazi Rexhepi" Paralelja në Sllatinë	29 prill 2021
4	Nga fondacioni Kosovë-Luksemburg -janë dhënë donacion 40 vitrina për nxënës dhe mjete tjera konkretizuese për laborator si	215 nxënës të klasave 6 dhe 7-ta në shumë shkolla të mesme të ulëta në komunën e Vitisë.	26.04.2021

	dhe dy kosha basketbolli dhe tepisonë për parashkollorë.		
5	18 kompjuterë nga Bashkatdhetarët nga Franca, ku u bë furnizimi i kabineteve të informatikës në dy shkolla të mesme të ulëta.	SHFMU “28 Nëntori” 9 Pc SHFMU “Nazmi Pajaziti” 9 Pc	Nëntor 2021
6	12 tabela shkrimi donacion nga një bashkatdhetare nga Austria.	SHFMU “Don Mikel Tarabulluzi”	Tetor 2021

10. Investime kapitale

- Intervenimi për renovim në disa shkolla , si p.sh tek SHFMU, “Ahmet Hajdari” Beguncë, është bërë vendosja e pllakave tek lavabotë e klasave.
- Lyerja e katit të tretë në SHFMU : Dëshmorët e Vitisë” në Viti, si dhe vendosja e pllakave në hyrje të tualeteve.
- Përrurimi i objektit të shkollës “Dëshmorët e Vitisë”, paralelja e ndarë në Drobesh më 18 janar 2021.
- Rregullimi i tribunave në SHFMU “Njazi Rexhepi” në Sadovinë të Çerkezve dhe paralelen e ndarë në Terstenik ku janë shtruar edhe pllakat ne hyrje të shkollës.
- Rregullimi i rrethojës së fushës sportive në SHFMU “Bafti Haxhiu” në Viti dhe ngjyrosja e paraleles së ndarë të kësaj shkolle në Ramnishtë, si dhe rregullimi i oxhakut të nxemjes.
- Rregullimi i disa dritareve të kuzhinës në Çerdhen “Gëzimi ynë” në Viti.
- Janë rregulluar dritaret dhe dyert në paralelen e ndarë të SHFMU ”Nazmi Pajzaziti” në Devajë.
- Janë bërë lyerje, shtruarje e dysHEMEVE plastike në 5 klasa në Shf.mu. “Dëshmorët e 5 Prillit” në Smirë.
- Mbjellja e drunjëve dekorativ në oborrin e SHFMU “28 nëntori” në Verban, dhe rregullimi i tribunës sportive(ulëseve të spektatorëve), gjithashtu edhe lyerja e brendshme e objektit shkollor dhe vendosja e pllakave në hyrje si dhe rregullimi i shkallëve të hyrjes.

- Rrethoja e fushës sportive ne SHFMU “Safet Rexhepi”, paralelja e ndarë në Ballancë.
- Ngjyrosja e Hallës Sportive e Shkollës Profesionale “Jonuz Zejnullahu” në Viti si dhe lyerja e brendshme e objektit shkollor me ngjyrë yndyore.
- Rregullimi i tualeteve dhe lyerja e objektit shkollor në SHFMU “Mirali Sejdiu”, paralelja e ndarë ne Gërmovë, si dhe shtruarja e pllakave në hyrje të shkollës, banjo, dhe intervenime tjera në Goshicë.
- Tribuna sportive në SHFMU ”Dëshmorët e Lubishtës” në Lubishtë si dhe lyerja e paraleles së ndarë në Podgorc.
- Vendosja e rrethojës së oborrit të SHFMU “Kenan Halimi” në Skifteraj dhe rregullimi i shkallëve me pllaka në hyrje të shkollës, si dhe lyerja dhe rregullimi i tualeteve te shkollës.
- Rregullimi i fushës sportive dhe i tribunave në SHFMU “Don Mikel Tarabulluzi”, Stubëll.
- Hapja e Çerdhes “Gëzimi Ynë” në Çifllak.
- Është bërë ngjyrosja e brendshme e shkollës së mesme të ulët “Hasan Alia ‘ Remnik.
- Vazhdojnë punimet në SHFMU “Halil Alidema’ në Pozheran.
- Është kryer edhe ngjyrosja e brendshme e objektit të shkollës së mesme “Kongresi i Manastirit’ në Pozheran.
- Sipas nevojës është kryer pjesërisht lyerja në SHML “Kuvendi i Lezhës në Viti”
- Është bërë asfaltimi i fushës sportive në paralelen e ndarë në Debellde të SHFMU “Ndre Mjeda” Kabash.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Ky raport është i bazuar në kërkesat dhe detyrat të cilat jemi të obliguar, që në harmoni me planet që janë të dale nga: "Plani zhvillimor Komunal" Nr.01-013/126 i datës 07.02.2011, "Plani Zhvillimor Urban" me Nr. 01-013/126, i datës 07. 02. 2011.

Planet rregulluese: "Zona Qendrore dhe Jugore dhe Lumi" me Nr.01-013/1275, i datës 21.02.2013 si dhe "Zona Veriore" me Nr.01-013/869, i datës 08.10.2013.

Implementimin e kriterëve ndërtimore të dalë nga: "Rregullorja për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve në Komunën e Vitisë" Nr. 01-013/317, të datës 15.03.2011.

Kontrollimi i planeve rregulluese detale të miratuara në raport me kërkesat për ndërtim nga qytetaret.

Kërkesa për dhënien e informatave për parcelat të ndryshme se çfarë destinim kanë me plane zhvillimore komunale dhe urbane.

Gjatë vitit 2021, kjo drejtori ka kryer këto punë dhe aktivitete të përshkruara sipas planit të punës për vitin 2021. Janë kryer këto punë dhe aktivitete të përshkruara sektor për sektor:

❖ Realizimi i të hyrave vetanake 154%

▪ Sektori i Urbanizmi:

Gjithsej : 94 .kërkesa

❖ Kërkesa për pëlqime urbanistik..... 12

- Të miratuara 10
- Të refuzuara 00
- Në proces 02

❖ Kërkesa për Legalizim71

- Të miratuara 68
- Në proces 04

❖ Kërkesa për Leje ndërtimi08

- Të miratuara 06
- Në proces/ 02

❖ Kërkesa për Leje rrënimi01

- Të miratuara 01
- Në proces 00

❖ Kërkesa tjera02

- Të miratuara 00
- Në proces 02

▪ Sektori i Planifikimit:

❖ Është punuar në ekip komunale për vlerësimin e zbatueshmerisë së Dokumenteve të Planifikimit PZHK dhe dhe PZHU-së dhe përgatitjen për hartimin HZK;

❖ Është përfunduar drafti për Planin Zhvillimor Komunal dhe janë përfunduar debatet nëpër lokalitete;

- ❖ Është përfunduar VSM-ja për Planin Zhvillimor Komunal dhe është miratuar nga ministria;
- ❖ Është formuar grupi punës për fillimin e hartimit të HZK-së.
- ❖ Në sektorin e planifikimit janë shqyrtuar 23 kërkesa të ndryshme Kërkesa për dhënie të informatave urbanistike.
- ❖ Gjithsejtë kërkesa:15
 - të shqyrtuara :15
 - Në proces 00
- ❖ vendime për kushte të ndërtimit të ndërtimit.....08
- vendime për kushte të ndërtimit në proces..... 00
- **Spektori i Mjedisit:**
 - Shpallja e vitit 2021 vit I ambientit në Komunën e Vitisë me vendim të kryetarit të Komunës së Vitisë, z.Sokol Haliti.
 - Gjatë kësaj periudhe janë shënuar ditët e ambientit 01-22 prill 202;
 - Janë mbajtur aktivitete pastrimi në shumicën e lokaliteteve të Komunës;
 - Është bërë pastrimi i hapësirave të varrezave të të gjitha komuniteteve fetare në bashkëpunim me KFOR-in amerikan;
 - Janë mbjell lule dhe drunj dekorativ;
 - Është shënuar “Dita Botërore e Mjedisit”, më 05 qershor 2021. Në aksion ku nën masat e parapara nga ISHPK kanë marrë pjesë mbi 200 pjesmarrës dhe janë larguar mbi 100 thasë mbeturina, janë mbjell 100 fidane lulesh dhe 30 drunjë dekorativ në parkun rreth lumit përball shkollave të mesme në qytet;
 - Janë shënuar të gjitha datat e ambientit me aktivitete të pastrimit të ambientit, në bashkëpunim me këshillat e fshatrave janë shënuar edhe në disa fshatra të Komunës;
 - Në vazhdimësi është bërë vlerësimi i gjendjes mjedisore, është bërë grumbullim i informatave nga terreni lidhur me çështjet mjedisore, të cilat janë në një raport të zgjeruar mbi gjendjen e mjedisit në Komunën e Vitisë.
 - Është në proces një leje mjedisore komunale për veprimtari.

Zyra e Adresave

- Në bazë të marrëveshjes, bashkëpunimi në mes Zyrës së Adresave të Komunës së Vitisë, Agjensionit Kadastral dhe shtetit Norvegjez, ku jemi përfitues të donacionit në vlerë mbi 15.000€, i cili është i dedikuar për vendosjen e numrave nëpër objekte, ndërsa tjetren shumë do ta siguroj komuna në bazë të marrëveshjes së lartcekur;

- Janë futur të dhënat në Sistemin ARIS, për një periudhë që e ka caktuar Agjësioni Kadastral;
- Kemi përfunduar vendosjen e 3000 numrave në objekte në qytetin e Vitisë dhe fshatin Kabash.

Kërkesa për adresë:

- ❖ Gjithsejtë kërkesa:02
 - të shqyrtuara :01

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Punët dhe aktivitetet e kryera në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për periudhën Janar – Dhjetor 2021 janë zhvilluar në bazë të programit të punës dhe kërkesave të parashtruara nga qytetarët dhe fermerët në lëmin e prodhimtarisë bujqësore. Në këtë periudhë raportuese, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i ka kryer të gjitha procedurat për fermerët që kanë të bëjnë me: plotësimin e aplikacioneve, dhënien e këshillave dhe dorëzimin e tyre në MBPZHR, në mënyrë që këta fermer të jenë përfitues të mundshëm të subvencioneve dhe granteve të ndarë nga niveli qendror dhe komuna.

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, gjatë vitit 2021 ka kryer këto aktivitete të punës, gjithmonë bazuar në planin vjetor të punës, të hartuar për vitin kalendarik Janar – Dhjetor 2021:

- Hartimi i planit të punës vjetor për vitin kalendarik 2021;
- Planet e punës mujore;
- Planet e punës gjashtëmujore;
- Raportet e mujore të punës;
- Punët rutine të kryera;
- Seminare dhe takime të ndryshme;
- Hartimi i projekteve;
- Vizita në teren, regjistrime, evidenca, statistika, këshilla etj.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, aktivitetet e saja i kryen përmes 3 sektorëve: Sektori për Bujqësi dhe Blegtori, Sektori për Pylltari dhe Sektori për Zhvillim Rural.

1.1 Sektori për Bujqësi dhe Blegtori

- Gjatë këtij viti janë bërë vizita të shumta në teren për grumbullimin e shënimeve në ferma, (është bërë rifreskimi i të dhënave mbi gjendjen në përgjithësi të të gjithë sektorëve të bujqësisë me të dhëna të reja;
- Hartimi i planeve mujore të vizitave në teren për grumbullimin e shënimeve në ferma;
- Hartimi i planit të mbjelljeve pranverore për vitin 2021;
- Përcjellja e statistikave bujqësore 19 vizita për këtë qëllim;

- Kontrollimi i materialit fidanor gjithsej 8 kontrollime;
- Kontrollimi dhe vizita e bletarëve 18 Kontrollime;
- Kontrollimi dhe vizita në ferma blegtorale gjithsej 16 vizita;
- Kontrollim dhe vizita e pemëve te imta gjithsej 18 vizita;
- Pranimi dhe plotësimi i formularëve si dhe regjistrimi i pronave të fermerëve për subvencione si: grurë, misër, perime në fushë të hapur, pemë, lopë qumështore, dele, dhi, derra, bletë, qumësht sipas cilësisë dhe pula vojse, ku janë pranuar gjithsej **797 aplikacione**;
- Për subvencione të grurit kanë aplikuar 301 fermer;
- Për subvencione të misrit kanë aplikuar 338 fermer;
- Për subvencione të perimeve kanë aplikuar 253 fermer;
- Për subvencione të pemëve kanë aplikuar 95 fermer;
- Për subvencione të pemë të imëta kanë aplikua 9 fermer;
- Për subvencione të bletëve kanë aplikuar 75 fermer.
- Për subvencione të deleve kanë aplikuar 63 fermer;
- Për subvencione të dhive kanë aplikuar: 14 fermer;
- Për subvencione të lopëve qumështore kanë aplikuar 67 fermer;
- Për subvencione të viqav kanë aplikuar 23 fermer;
- Për subvencione të derrave kanë aplikuar 2 fermer;
- Për subvencione të qumështit sipas cilësisë kanë aplikuar 30 fermer;
- Për subvencione të pulave vojse kanë aplikuar 3 fermer;
- Vizitë, (inspektim), mullinjve për verifikimin e masave të marra për kryerjen e 3 DDD. Janë vizituar të gjitha depot e mullinjve (2 mullinj), së bashku me inspektorin e bujqësisë;
 - Sektori për bujqësi dhe blegtori ka përcjell fushatën e korrje shirjes gjatë muajit korrik. Në komunën tonë kanë qenë të mbjell 4850 ha me grurë, ndërsa numri i autokombajnervë të angazhuar në fushatë ka qenë 104 autokombajner. Fushata ka filluar më 07.08.2021 dhe ka përfunduar më 02.09.2021 Rendimenti mesatar në Komunën e Vitisë ka qenë 4597.05kg/ha.

1.2 Sektori për Pylltari dhe Zhvillim Rural

- Përgatitja e planit të prerjes në bashkëpunim me APK-në 2021;
 - Kryetari i Komunës së Vitisë ka shpallur vitin 2021 vit të mbrojtjes së pyjeve;
 - Në bazë të vendimit të kryetarit të Komunës së Vitisë DBPZHR-ja ka hartuar planin operativ për mbrojtjen e pyjeve;
 - Vizita në paralelet e prerjes;
 - Shqyrtimi i kërkesave për prerje në pyjet private;
 - Takime të rregullta me stafin e pylltarisë, realizimi i detyrave të punës;
 - Konfiskimi i masave të druve të vëna në qarkullim pa dokumentacionin e nevojshme, ku janë konfiskuar 15.30 m³ dru edhe 7 automjete transportues, siç janë: kombi, kamionetat si dhe kamionat dhe është konfiskuar motorsharr për prerjen e drurëve;
 - Gjatë vitit 2021 janë mbyll me eskavator mbi 4 rrugë në pyje, me qëllim të pengimit të prerjeve ilegale të pyjeve, ku kanë ndikuar mjaftë në zvogëlimin e dëmeve;
 - Gjatë vitit 2021 janë mbajtur dy takime me kryetarin e komunës, komandantin e Stacionit Policor në Viti dhe kryetarin e Gjykatës Themelore - Dega në Viti, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve për ndalimin e prerjeve ilegale;
 - Në bashkëpunim me policinë janë realizuar disa kontrolla rutine në tregje dhe rrugë kyçe, që kanë rezultuar me konfiskim të masës drurore të prerë ilegalisht;
 - Gjatë periudhës njëvjeçare nga ana e rojeve të pyllit janë bërë gjithsej 139 fletëparaqitje për dëme në pyje;
 - Gjatë vitit 2021 janë konfiskuar 15.30 m³ dru zjarri;
 - Kërkesa të parashtruara për pyje private gjithsej 27 kërkesa;
Të shqyrtuara dhe miratuara 16 kërkesa;
- Më datë 14.10.2021, është mbajtur panairi bujqësor me moton “T”i ruajmë vlerat tona tradicionale”. Ky panair u organizua nga Drejtoria e Bujqësisë dhe grupi lokal i veprimit “VITIA” në bashkëpunim me organizatën Suedeze IKC. Qëllimi i këtij panairi ka qenë që, pjesëmarrësit t’i promovojnë prodhimet e tyre, si ato: bujqësore, blegtorale, përpunuesit e ujit dhe pijeve alkoolike, ushqime tradicionale, punime artizanale etj.

1.3 Aktivitete Rutinore

- Gjatë vitit 2021 komisionet komunale për vlerësimin e dëmeve në bujqësi dhe blegtori kanë bërë vlerësimin e dëmeve të shkaktuar nga faktor të ndryshëm si klimatik, në fusha të ndryshme të bujqësisë dhe blegtorisë, ku vlera totale e dëmeve është: **200,846.71 €**. Ky komision është bërë në bashkëpunim me DBPZHR dhe përmes MBPZHR për dëmet e shkaktuar gjatë majave Maj –Qershor;
- Organizimi i 1 trajnimit në bashkëpunim me shërbimin këshillimorë të MBPZHR;
- Menaxhimi i fermave bujqësore, mbajtja e kontabilitetit dhe librave në ferma (këshilla praktike);

- Grumbullimi i të dhënave statistikore;
- Vizitë të gjithë kombajnerëve rreth përgatitjes teknike të kombajnave dhe verifikimi i numrit të tyre. Gjithsej në komunën tonë janë 104 kombajna;
- Takime me organizata të ndryshme: si: IKC ,UNDP-ja, IADK Fondacioni Kosovë Luxemburg, Caritasi Zvicrran etj .

1.4 Të hyrat nga taksat komunale që i përkasin Drejtorisë së Bujqësisë

Duke u bazuar në të hyrat që krijohen nga grumbullimi i taksave komunale nga domeni i bujqësisë paraqitet kjo gjendje:

Të hyrat nga:

- Ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në atë ndërtimore: 3,621.5 € dhe
- Vërtetime për veprimtari bujqësore: 50 €

Gjithsej të hyra 3.621.5 €

1.5 Shqyrtimi i kërkesave të drejtuara përmes arkivit të komunës

Gjatë këtij viti nga arkivi i komunës kanë arritur gjithsej 65 kërkesa, prej tyre:

Të bartura nga viti paraprak	Të pranuar në vitin 2020	Gjithsej të pranuar	Të miratuara	Të refuzuara	Gjithsej të shqyrtuara
/	65	65	64	1	65

Kurse, sa i përket kërkesave që i drejtohen drejtorisë pa procedurë të arkivit, numri i tyre është i madh dhe kryesisht kanë të bëjnë me shqyrtimin e mundësisë së subvencionimit të kulturave bujqësore që kultivohen nga ana e tyre.

1.6 investimet nga komuna dhe organizatat (donatorët) në fushën e bujqësisë gjatë vitit 2021

Komuna e Vitisë dhe Organizata IKC:

Komuna dhe IKC kanë shpërndarë inkubator për qeljen e vezëve, ku përfitues kanë qenë 30 fermerë të Komunës së Vitisë.

Fermeri: 25 % 35€

Komuna: 75 % 4.200.00 €

IKC: 700 € - 16.68 %

Vlera e projektit: 5425.00 €

Komuna e Vitisë me DBPZHR:

Komuna e Vitisë ka shpërndarë 50 centrifuga për bletë bashkëfinancim me fermerin. Përfitues 50 fermerë të Komunës së Vitisë:

Komuna: 75 % 11,497.5 €

Fermerët: 25% 3,832.5 € (një fermer paguan 76.65 për një centrifugë)

Vlera e projektit: 15. 330 €

Komuna e Vitisë me Organizaten Caritasi Zvicrran:

Drejtoria e Bujqësisë në bashkëpunim me Caritasin Zvicerran në kuadër të projektit “Zhvillim i Qëndrueshëm dhe Gjithëpërfshirës Ekonomik Rural (SIRED)”, sot është bërë inaugurimi i linjës së përpunimit të frutave e perimeve, konkretisht të pasterizimit të tyre si dhe ambalazhimit e produkteve nga agrobiznesi “GRASEP” në Sllatinë të Epërme të Vitisë.

Komuna : 25.000 €

Fermerët : 7.275.0 €

Caritasi Zvicran: 48.500 €

Vlera e Projektit : 80.775.00

Ditën e Çlirimit të Komunës së Vitisë, u hap edhe Panairi i produkteve bujqësore, industriale e artizanale, në sheshin e qytetit “Nijazi Azemi”.

Komuna e Vitisë me organizatën IADK-ën

Organizata IADK ka ndihmuar një femër në hapjen e biznesit të ri në fshatin Lubishtë me mjete për ngritjen e njësisë për përpunim të qumështit.

Fermeri : 8 % 1,200.00 €

Komuna : 20 % 3,120.00 €

IADK : 72 % 11,280.00 €

Vlera e projektit: 15,600.00

Drejtoria e Bujqësisë dhe organizata IADK ndihmuar 9 fermer me grante ne sketorin e pemëve dhe perimeve me vlerë 3.000€ .

Fermeri : 2,700.00 €

Komuna : 5,400.00 €

IADK : 18,900.00€

Vlera e projektit: 27,000.00 €

Drejtoria e Bujqësisë dhe organizata IADK ka përkrahur një fermere femër për ngritjen e njësisë përpunuse për përgatitjen e ëmbëlsirave.

Fermeri : 1,200.00 €

Komuna : 2,400.00 €

IADK : 8,400.00€

Vlera e projektit: 12,000.00€

1.7 Investime nga MBPZHR

- Grandet

- a. Nga Ministria e Bujqësisë ende nuk është publikuar lista e përfituesve .
Vlera te investimeve për Grande ende nuk është publikuar.
- **Pyllëzimet**
- b. Gjatë vitit 2021 nga MBPZHR dhe është pyllëzuar 5/ha, gjegjësisht Agjensioni Pyjor i Kosovës, mbi fshatin Lubishtë .
- **Subvencionet**
- c. Gjatë vitit 2021 kanë përfituar subvencione 797 fermer nga fusha të ndryshme të bujqësisë, vlera e subvencioneve është ende ne proces ku parashihet të jetë mbi **2,000,000 €**
- Vlera totale e përfituar nga ana e fermerëve Vitias është: €**

1.8 Shuma e përgjithshme e investimeve në bujqësi, nga Komuna, Ministria dhe donatorët gjatë vitit 2021

INVESTUESI	SHUMA
Komuna e Vitisë dhe donatorët	178.548.00€
Ministria e Bujqësisë(subvencionet dhe grandet)	200.846.71 €
Totali i investimeve për vitin 2021	379.394.71€

Drejtoria për Kadastrë, Pronë dhe Gjeodezi

Në kuadër të DKPGJ-së ekzistojnë tre sektorë:

- Sektori i Kadastrit
- Sektori i Pronës, dhe
- Sektori i Gjeodezisë

1.1 Sektori i Kadastrit

Puna në Sektorin e Kadastrit është e bazuar në dispozitat ligjore, të cilat e rregullojnë këtë sektor, i cili është përgjegjës për kujdesen dhe mirëmbajtje e të gjitha regjistrave kadastral, ku përfshihet e gjithë paluajtshmeria komunale, si dhe regjistri i paluajtshmerive, hipotekave, servituteve digjitale dhe manual, si shërbim kryesor për qytetarët si shërbimi me lëshimin e fletave poseduese, certifikatave personale dhe social.

Gjatë kësaj periudhe në këtë sektor janë kryer këto shërbime kadastrale:

Muaji	Fleta poseduese Me/pa pagës	Certifikata për N. sociale	Hipoteka	Transaksione Pronësore
Janar- Dhjetor	4504/copa	512		1436 lëndë

Tabela nr.1 Shërbimet kadastrale për periudhën Janar – Dhjetor 2021

1.2 Sektori i Pronës

Sektori i pronës ka përgatitë 5 propozim vendime për bordin e drejtoreve dhe Kuvendin komunal, ne lidhje me natyrën e punëve ne Drejtori në vazhdimësi ka bërë interpretimin e normave ligjore që janë në fuqi, ka kryer punë administrative në Drejtori: përpilimin e aktvendimeve, urdhëresave dhe akteve tjera, ka lëshuar vërtetime për pronat qe komuna nuk ka interes ti blejë ato.

I ka pranuar kërkesat e drejtuar Drejtorisë, i ka shqyrtuar ato dhe ju është përgjigjur me shkrim. Ka zhvilluar procedurat për ekspropoim të tokave në pronësi private për interesa të përgjithshme publike.

1.3 Sektori i Gjeodezisë

Sektori i Gjeodezisë për gjatë vitit ka kryer këto shërbime për palët dhe Komunën si ka : Mirëmbajt kadastrën digjital në sistemin kosovaref01 ka përcjell vektorizimin e raster planeve, ka përgatitë dhe mbikëqyrë të dhënat për kompanitë dhe gjeodetët e licencuar, ka përgatitë raportet ditore për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ka pranuar lëndët e kryera nga kompanitë dhe gjeodetët e licencuar dhe të njëjtat i azhurnon në sistemin zyrtar (SIKTK-T dhe SIKTK-G), ka bërë azhurnimin e ndarjeve fizike në librat e regjistrimeve të nënndarjeve kadastrale, ka bërë Hartimin e kopjeve të Planit, Kontroll të vazhdueshme kualitetit të të dhënave grafike kadastrale dhe atyre tekstuale, projektim të rrjeteve referente, të rendit të tretë të shtruar me GPS, Identifikim i parcelave në zyrë. Futja e të dhënave grafike në datamodelin zyrtar (SIKTK-G). Konsulta dhe këshilla profesionale në lëminë e Gjeodezisë dhe Kadastrës, për palët e interesuara në kuadër të shërbimeve kadastrale.

Muaji	Kopjet planit Me pag/pa pag	Produkte për kompanit ë private	Ndarje/azhurni me	Bashkimpar celave	Totali Lëndeve
Janar- Dhjetor	925	5351	287/21760	85	373

Tabela Nr.3 Shërbimet në sektorin e Gjeodezisë

Të hyrat financiare

Në Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi planifikimi i të hyrave buxhetore për vitin 2021 duke përfshirë të gjithë sektorët ka qenë 74,200.00€, kurse realizimi i të hyrave deri në periudhën Janar – Dhjetor 2021 është 95.948.00 €.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

- Janë organizuar aktivitete të ndryshme kulturore, sportive dhe letrare, si “Flakadani i Karadakut”, shënimi i ditëve me rëndësi kulturore dhe historike të Komunës
 - Është bërë Subvencionimi i 11 entiteteve publike me 38,000€, 50% e mjeteve të transferuara për klubet sportive, shoqëritë kulturo artistike dhe organizatat lokale të shoqërisë civile
 - Me 2 qershor 2021 është bërë përrurimi i Muzeut të Qytetit Viti me 2 qershor 2021
 - Palestra e sportit në Drobesh – vazhdim i punimeve
 - Stadiumi në Vitisë – (përrurim u bë me 14 qershor – Dita e çlirimit të Vitisë)
 - Stadiumi “Ibrahim Kurteshi “ në Pozheran – vazhdojnë punimet
 - Stadiumi ndihmës i KF “Vllaznia” nga Pozheranit – i kryer
 - Fusha e sportit e shtruar me gomë në Pozheran
 - Fusha sportive e shtruar me gomë në Sllatinë të Epërme
 - Pista e tribunave të fushave sportive me ulëse në fushat: Lubishtë, Remnik, Tërpezë, Vërban dhe Budrikë
 - Shpallja e sportisteve - Laureatëve të vitit 2020
- P.S Raportin e detajuar të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport mund ta merrni në zyrat e drejtorisë.

Viti, Janar 2022

Kryetari i Komunës

Sokol HALITI

